Rezultati gjeneroi mirënjohje mes organizmave ndërkombëtare dhe debat politik në vend. Historitë e suksesit të aktivitetit të Co-PLAN shërbyen si dëshmi dhe baza të forta për ndërtimin e partneriteteve me pushtetin vendor dhe qëndror; moment kulmor në aktivitetin e Co-PLAN është shënuar nga programi EGUG [Enabling Good Urban Governance], Mundësimi i Qeverisjes së Mirë Urbane, financuar nga Qeveria Holandeze- i cili shërbeu si pikë referimi për programe të tjerë të donatorëve të huaj, si UNDP dhe World Bank.

Rritja dhe zhvillimi i Co-PLAN ka qënë një përgjigje ndaj tri fazave të zhvillimit dhe qeverisjes urbane në Shqipëri, duke qënë një përpjekje per t'iu përgjigjur dhe për t'i paraprirë problemeve të tij.



1990

1992



1994

1997



2000

2005



2010

Vitet ’90 – Qyteti i ndërtuar nga njerëzit!

Një fazë gjatë së cilës shoqëria Shqipëtare u gjend para pikëpyetjeve të mëdha në lidhje me identitetin e saj dhe ndryshimet socio-politike që po përjetonte. Lëvizjet e mëdha e të pakontrolluara demografike, qartësisht reflektuan nevojën për qasje te planifikimit urban për adresimin e problematikës së urbanizimit të përshpejtuar. Me moton ‘Qyteti i ndërtuar nga njerëzit’ Co-PLAN ndërtoi me sukses modele dhe skema pilot në zonat periferike e informale.

Vitet 2000-2005 – Qytetet motorrë të zhvillimit!

Thellohet kriza hapësinore për shkak të rritjes së pakontrolluar të qëndrave të banimit dhe shpërndarjes pakriter. Instrumentet e kontrollit dhe planifikimit të asaj kohe ishin të pamjaftueshëm, tek sa koncepti i ‘qytetit’ ndryshoi me dinamika kaotike, kryesisht të paplanifikuara.

Në thelb të kësaj problematike, Co-PLAN zhvilloi ekspertizën ë saj planifikuese të tipit rregullues e strategjik në nivel qyteti/bashkie. Spikat program EGUG [enabling good urban governance], i cili shënon një hap të rëndësishëm në planifikimin urban shqipëtar; përtej modeleve tradicionalisht të aplikuara.

Vitet 2005 – Drejt Ndikimit në Politikë-bërje!

Kjo periudhë shënon hyrjen e Shqipërisë në një fazë konsolidimi; zhvillimi dhe integrimi euroatlantik. Për pasojë, shënohet një reduktim i programeve të mbështetura nga organizatat ndërkombëtare. Në shoqërinë shqiptare vërehen shenjat e para kontradiktore të aspiratave europiane , që u rritën përtej asaj që mundësonte realiteti.
Kjo periudhë reflektimi për Co-PLAN nxorri në pah domosdoshmërinë e burimeve njerëzore të kualifikuara me ekspertizë në planifikim dhe arkitekturë, si dhe nevojën për të ndikuar në politikë-bërje. Viti 2006 shënoi themelimin e Universitetit Polis.

Sfida!

Nuk kanë munguar paragjykimet, debatet, dhe presionet. Në këtë atmosferë, Co-PLAN ka zgjedhur të pozicionohet në mbështetje të interesit publik dhe komunitetit. Tashmë synojmë të promovojmë një sistemi të ri planifikimi hapësinor kombëtar dhe qeverisjeje, në linjë me atë që shtetet e BE po ndërtojne prej disa dekadash. Nëpërmjet propozimit të Platformave Politike, Co-PLAN synon të provokojë debat; disa ide tashmë janë adoptuar në iniciativa zyrtare ligjore; ide të tjera janë hedhur në tryezat e debatit politik.






















KËNETA 2004 - ext 2009











BATHORE 1997- 2005

ORGANIZATA

Co-PLAN

- MISIONI I ORGANIZATËS
- DREJTORI EKZEKUTIV I Co-PLAN
- BORDI DREJTUES DHE BORDI KËSHILLIMOR
- EKSPERTËT E Co-PLAN

> Misioni i Co-PLAN

Ne punojmë me njerëz dhe institucione, për të nxitur transformim social të prekshëm dhe ndryshime pozitive në terren, duke prodhuar njohuri promovuese për një manaxhim më të mirë të habitatit.

> Organizata jonë

Co-PLAN është një organizatë jofitimprurëse që kontribuon në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm urban dhe rajonal duke mundësuar një qeverisje të mirë, dhe duke adresuar çështje të thelbësore të mjedisit, duke zhvilluar shoqërinë civile, dhe nxitur pjesëmarrjen e komunitetit.

> Habitati ynë

Që nga themelimi, fokusi i punës së Co-PLAN ka qënë mbi 'habitatin', në Co-PLAN ne jemi shumë entuziastë për të nxitur ndryshimet urbane për të përmirësuar mjedisin ku jetojmë. Në 15 vitet e fundit, ne jemi angazhuar në një sërë projektesh mbi planifikimin urban të qytetit si pjesë e reformës së zhvillimit hapësinor.

> Shoqëria jonë

Njërëzit janë një element thelbësor i aktivitet tonë; në fakt, gjithçka ndërtohet rreth jetës dhe mirëqënies së njerëzve, duke përmirësuar mjedisin ku jetojnë, dhe duke i bërë ata një pjesë shumë aktive të proçesit të vendim-marrjes që u përket ose ka ndikim në jetën e tyre në një formë ose tjetër. Ajo që mund të fillojë si një projekt me rezultate të prekshme, apo si një seminar apo kurs trainimi, shpeshherë rezulton në një shoqëri civile më të fuqizuar.

> Puna jonë kërkimore

Aktiviteti i Co-PLAN nuk kufizohet thjeshtë në promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë; në Co-PLAN, ne e studjojmë proçesin në mënyrë të hollësishme, dhe prodhojmë njohuri të rëndësishme e cila i shton aktivitetit tonë një dimension më shumë, duke shërbyer si tregues për përmirësim të mëtejshëm të politikave dhe proçeseve të fushave tona të ekspertizës. Në rastin më të mirë, njohuritë që ne prodhojmë shërbejnë për të drejtuar / orientuar proçeset e politikë-bërjes, dhe ndërtimit të qyteteve, dhe shërbejnë si bazë për proçese reflektimi për të inkurajuar rritje dhe përmirësim të mëtejshëm.

> Partnerët tanë

Partneritet përbëjnë një vlerë karakterizuese në filozofinë e aktivitetit të Co-PLAN. Ne jemi krenarë për partnerët me të cilët punojmë, dhe gjatë 15 vitete të fundit kemi punuar shumë për forcimin e marrëdhënieve me partnerët tanë në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Ndaj dhe, jemi të lumtur të ndajmë çdo sukses me secilin prej partnerëve tanë, duke qënë se ata të gjithë, në një mënyrë ose tjetër, kanë kontribuar në rritjen e vazhdueshme dhe suksesin e Co-PLAN.

& DREJTORI EKZEKUTIV I Co-PLAN BORDI DREJTUES



Dritan Shutina - Drejtor Ekzekutiv i Co-PLAN

Dritan Shutina është Drejtori Ekzekutiv i Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, që nga viti 2005, të cilën ai e bashkë-themeloi në 1995. Ai është gjithashtu një nga themeluesit e Universitetit Polis, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Zhvillimit të Politikave Urbane, ku ai kryeson njësinë kërkimore dhe angazhohet në mësimdhënien e planifikimit strategjik. Ai u diplomua në Inxhinieri civile dhe më tej kreu studimet pas-universitatre në Politika Publike, Vlerësim të Tokës dhe Ndërtimit, Zhvillimi Urban i Qytetit, në institucione evropiane dhe amerikane. Fushat e tij kryesore të ekspertizës janë: qeverisja lokale dhe decentralizimin, planifikimi urban strategjik, formulimi i politikës publike, manaxhimin i ciklit të projektit, e vlerësimit të projektit, zhvillimit organizativ dhe institucional, zhvillimin e shoqërisë civile, manaxhim e procesit, manaxhim njohurish, manaxhimi aktivitetesh, moderim, dhe trajnim.

Gjatë 15 viteve të fundit, Dritani ka punuar në projekte në fushën e planifikimit të lagjes dhe qytetit, organizimit dhe zhvillimit institucional, hartimit të projekteve, monitorimit dhe vlerësimit, decentralizimit dhe reformave të pushtetit lokal, planifikimit urban dhe manaxhimit, financimit komunal, zhvillimi i shoqërisë civile dhe demokratizimit, kryesisht në Shqipëri, por edhe në Kosovë.

Ai ka fituar përvojë të gjerë në fushën e trainimeve, pedagogjisë dhe menaxhimit të qeverisjes vendore, dhe të manaxhimit financiar, dhe ka zhvilluar aftësi të shkëlqyera në politikën e këshillimit, rrjeteve dhe, komunikimi raportimit dhe të manaxhimit të ciklit të projektit.

Sokol Çelo - Drejtues Bordi

Aktualisht është Asistent-Profesor për lëndën e Manaxhimit të Biznesit Ndërkombetar pranë Universitetit Suffolk, në Boston, SHKBA. Ai kreu studimet e doktoraturës për Biznes Ndërkombëtar në Universitetin Ndërkombëtar të Floridës. Fokusi i programit të tij ishte në këndvështrimin institucional të investimeve të huaja në vendet ish-komuniste dhe ato në tranzicion.
Fillimisht, Sokoli u diplomua në Matematikë në Universitetin e Tiranës dhe më tej përfundoi programin Master nëAdministrim Biznesi të ofruar nga Universiteti iTiranës dhe ai i Nebraskës.
Ai e filloi karrierën e tij profesionale në fushën akademike si pedagog i Matematikës në Universitetin e Tiranës dhe vazhdoi më tej në fushën e projekteve zhvillimore duke punuar si menaxher projekti për GTZ dhe më vonë për PNUD. Sokol Çelo është anëtar dhe Kryetar i Bordit Drejtues të Co-Plan prej 9 vitesh.





Dr Besnik Aliaj - Anëtar Bordi

Diplomuar në 1990 në Arkitekturë-Urbanistikë në Universitetin Politeknik të Tiranës (UPT), Studime pasuniversitare në pasuri të patundshme 1994-1995 (UPT). Dr Aliaj kreu studimet Master në Menaxhim Urban në 1996 në Universitetin Erasmus, Holandë, të ndjekur nga programi doktoraturë në Planifikimin Urban në 2006. Ai është aktualisht në proçesin e marrjes së titullit 'Profesor'. Dr Aliaj është angazhuar në shumë trajnime profesionale dhe kërkimore shkencore në Kolegjin IPC, Danimarkë (1994), Universitetin e Oslos (1995), etj.
Ai është një nga bashkë-themeluesit, dhe aktualisht Rektori i Universitetit POLIS, Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Zhvillimit të Politikave Urbane, ku ai gjithashtu jep lëndën e Dizajnit Urban. Përvoja e tij profesionale si pedagog për 16 vjet, u pasurua më tej nga pozicioni i tij si Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Civile në Universitetin Politeknik të Tiranës për 3 vjet. Ai ka përvojë të konsiderueshme pune me njësitë e qeverisjes qëndrore dhe lokale, dhe është aktualisht anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës.
Ai është autor i disa publikimeve, artikujve shkencorë dhe forumeve lokale, duke përfshirë edhe periodike shqiptarë mbi arkitekturën dhe planifikimit urban: «Forum A + P».
Për kontributin dhe punën e tij, ai ka fituar çmimin "Fisnikëria Tiranase" në vitin 2004 dhe çmimin "Qytetar Nderi i Kamzës" në vitin 2006.

Sotir Dhamo - Anëtar Bordi

Sotir Dhamo kreu studimet Master në Administratën Publike në Universitetin e Sirakuzws, New York. Ai është Administrator i Bordit themelues të Universitetit POLIS, Shkollës Ndërkombëtar të Arkitekturës dhe Zhvillimit të Politikave Urbane. Ai aktualisht jep mësim të dy lëndëve: Projektimi Urban, dhe Analiza e Territorit dhe Vendbanimet Njerëzore.
Ai është anëtar i Këshillit të Redaksisë dhe redaktor i revistës shkencore të Universitetit POLIS: "Forum A + P", e njohur nga Ministria e Arsimit të Lartë dhe Shkencës. Ai ofron Konsulencë në kuadër të Studios Metro_POLIS në fushën e planifikimit urban dhe dizajnit urban si pjesë e Universitetit POLIS; kryen aktivitet kërkimor në kuadër të IKSH_POLIS . Ndër të tjera, përvojat e tij profesionale përfshijnë pozitën e Drejtorit të Projektit Manaxhimit të Tokës Urbane në Ministrinë e Punëve Publike, dhe kreun e departamentit të planifikimit urban ligjor në Institutin e Planifikimit Kombëtar në Tiranë. Ai ishte punësuar edhe si një ekspert lokal në kuadër të projektit "Forcimi i Qeverisjes Lokale dhe pjesëmarrja qytetare", financuar nga VNG – Shoqata Hollandeze e Bashkive. Sotiri ka punuar për Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në Tiranë, Shqipëri.
Ai është autor i shumë publikimeve, artikujve shkencorë, përfshirë këtu: Formulari City - midis morfologjisë së kaosit dhe të rendit, Forum A + P 5, revistë shkencore e Universitetit POLIS, Manifest për Transformimin e Tetovës, 2010 etj.



BORDI KËSHILLIMOR



Dr Peter Nientied

Dr Peter Nientied është Konsulent dhe Trajnuesi Manaxhim Menaxhimit dhe Trajner. Ai është këshilltar i asociuar i DBR.
Peter kreu doktoratën e tij në shkencat sociale në Universiteti Free të Amsterdamit. Ai punoi për I.H.S. – Universitetin e Erasmus, dhe realizoi projekte të ndryshme në fushën e menaxhimit urban. Në IHS, ai asistoi disa studentët shqiptare, dhe nga ato kontakte lindi një marrëdhënie e gjatë dhe e qëndrueshme me Co-Plan, dhe më vonë me Universitetin Polis.
Ai jep lëndën e 'Qyteteve Krijuese' në Universitetin Polis dhe kontribuon me artikuj dhe kërkime mbi këtë temë.



John Driscoll

Është Drejtor i Qendrës Ndërkombëtare për Zhvillim Vendor e Rajonal, një qendër kërkimore në Armagh, e cila është rezultat i një partneriteti mes universiteteve në SHBA, dhe qendrave kërkimore të përfshira në planifikimin hapësinor. Ai është nënkryetar i Institutit për Bashkëpunim Ndërkombëtar i Zhvillimit Urban në Cambridge, Massachusetts, dhe një hulumtues në Qendrën Universitare të Harvardit për Studime të Strehimit. Nga 1989 deri më 2005, ai ishte hulumtues dhe pedagog në Qendrën për Studimet e Planifikimin dhe Zhvillimit Urban, në Shkollën Pasuniversitare të Harvardit



Sef Slootweg

Është një nga bashkëthemeluesit e Co-PLAN. Ai ka punuar për vite me rradhë për Zyrën Kërkimore dhe këshillimore për politikat, çështjet urbane dhe sfidat sociale të strehimit në Hollandë. Në vitin 1990, ai hodhi themelet e 'Crossover' me qëllim për të shkëmbyer përvojën në çështjet e strehimit midis ekspertëve Hollandezë dhe Evropës Lindore. Kjo përvojë e solli atë në Shqipëri, ku ai punoi për gjetjen e zgjidhjeve për rritjen e shpejtë të zonave informale të banimit në Tiranë. Në vitin 1999, ai u bashkua me SNV, e cila i ka mundësuar të punoje në Shqipëri dhe Afrikën Perëndimore



Ferry van Wilgenburg

Ferry ka përvojë të konsiderueshme në fushën e menaxhimit urban, veçanërisht në vendet aziatike.
Ai ka punuar për më shumë se 5 vjet në Roterdam, Holandë, si menaxher i programit të zhvillimit të lagjeve dhe si menaxher i pasurive të patundshme. Ai aktualisht punon në një organizatë të strehimit shoqëror, si menaxher i pasurive të patundshme.



Valdet Sala

Është këshilltare e jashtme për Co-PLAN nga viti 1999. Ajo drejtoi bordin e drejtuesëve të Co-PLAN nga viti 2002 deri në 2007. Së fundmi ajo ka drejtuar Programin e GTZ GOPA mbi përfshirjen e shoqërisë civile në Shqipëri. Gjatë karrierës së saj profesionale, ajo ka mbajtur poste të rëndësishme; është themeluese e tre OJQ-ve në fushën gjinore, dhe ka botuar disa artikuj në këtë temë.Në vitin 2005, ajo mori çmimin për lidership për kontributin e saj të shquar brenda shoqërisë civile



Stafi Co - PLAN

Në Co-PLAN, njerëzve u pëlqen sfida; ata janë ndër ekspertët më të mirë të fushave që përfaqsojnë, dhe i shtojnë eksperiencë të çmuar dhe profesionalizëm Co-PLAN-it. Ekspertët tanë janë të rinj, energjikë, dhe vijnë nga fusha të ndryshme, gjë që përfaqson më së miri filozofine e punës në Co-PLAN.

www.co-plan.org







AKTIVITETE

11

- MBI LIGJIN E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
- POLITIKËNDJEKËS APO POLITIKËBËRËS! - KRITIKË LETRARE
- PROMOVIMI PARTNERITETEVE PËR QYTETE TË MUNDËSIVE TË PËRBASHKËTA [MATRA]& EXPO POLIS
- TRYEZË KOMBËTARE: TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME
- TRYEZË KOMBËTARE: FORUMI URBAN
- TRYEZË KOMBËTARE: TRANSFERTAT NDËRQEVERITARE
- RICIKLIMI I MBETJEVE
- TRYEZË KOMBËTARE: INSTRUMENTET FINANCIARE AFATMESME
- JAVA ARKITEKTURORE NË SOFJE
- EMAS easy - RASTI I QYTETIT TË FIERIT
- ARCHIS SEE 2010



MBI LIGJIN E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Pikëpyetja e Madhe e Planifikimit Urban

Na rrethon. Na jep trajtën. Jetojmë në të: 20 vjet përhapje urbane dhe zhvillim mbushës i pakontrolluar, që po [sh] formon peisazhin Shqipëtar me një ritëm që ne nuk mund ta përballojmë. Mënyra se si sipërmarrja e lirë u [keq] kuptua është rrënjosur në të gjitha ndërtimet informale, godinat shumëkatëshe të panumërta që kanë mbirë thuajse gjithandej, si dhe qytetet e mbipopulluara. Periferia e sapo-lindur është bërë aq kompakte sa kaosi është kthyer në një formë rregulli në vetvete. 270,590 godinat informale injorojnë kriteret e planifikimit dhe menaxhimit urban; të prirura nga interesi vetjak, dhe të ngritura, shpesh-herë, në çfarë mund të kishte qënë hapësirë e gjelbër publike për përdorim kolektiv dhe përfitimin më të gjërë të shoqërisë.

Sot, ne përballemi me një realitet të shformuar; qoftë nga pikëpamja estetike, ashtu dhe nga ana e tregut dhe funksionalitetit, e pamundur të përmbahet nga korniza e trashëguar ligjore. Atëhere, ku jemi ne dhe ligji në të gjithë këtë katrahurë urbane?

Pas një refuzimi të gjatë e të vazhdueshëm për të pranuar e adresuar gjëndjen, gjë që shkaktoi përkeqësimin e mëtejshëm, Parlamenti Shqipëtar aprovoi në vitin 2009 ligjin e shumëpritur mbi Planifikimin e Territorit. Ekspertët e Co-PLAN analizuan ligjin e ri nga aspekti legjislativ, kontekstual dhe territorial. Nëpërmjet ligjit të ri të planifikimit të territorit është kërkuar të adaptohet një qëndrim shumë-dimensional ndaj situatës, duke prezantuar koncepte të reja dhe duke lidhur planifikimin e territorit me zhvillimin. Kjo në vetvete, përbën 'një hap të rëndësishëm institucional', dhe për pasojë, një sfidë kur përballesh me mundësitë për ta implementuar në kontekstin kompleks urban, me kapacitete të mangta për sa i takon kritereve teknike urbane. Një shembull ilustrues është rasti i infrastrukturës, aspekti më i nënvlerësuar në këtë valë të fuqishme ndërtimesh.

Në vitin 2010, Co-PLAN mori pjesë në një projekt, me qëllimin për t'i asistuar Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit dhe të gjitha grupeve të interesuara dhe të prekura nga ky ligj, përfshirë njësitë qeverisëse vendore, për hartimin e tre rregulloreve si një pjesë thelbësore e akteve nënligjore të Ligjit të ri. Duke marrë në konsideratë mangësitë, në nivel teknik dhe kontekstual, hartimi i saktë e realist i akteve nënligjore, dhe përshtatja e legjislacioneve ekzistuese, përbëjnë domosdoshmëri për implementimin [deri diku] të suksesshëm të Ligjit të ri. Në varësi të zhvillimeve, 2011 mund të shënojë një kthesë të rëndësishme në debatin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit në Shqipëri.

Deri më atëhere, do të na rrethojë. Do të na kufizojë. Do të përcaktojë çfarë do të bëhemi.

POLITIKËNDJEKËS APO POLITIKËBËRËS!


Vlerësim Kritik nga Prof. Dr. Artan Fuga

Politikat e administrimit të territorit në një botim shkencor

Botimi Politikëndjekës apo Politikëbërës!, botimi i njëhershëm i Universitetit “Polis” dhe i instituteve studimore “Co – Plan” dhe “Metropolis”, me editorë Dritan Shutina dhe Rudina Toto, sjell në vëmendje të lexuesit probleme që kanë të bëjnë me politikat e administrimit të territorit në aktualitetin e Shqipërisë të tranzicionit.
Ajo që bie në sy menjëherë është se logjika e këtij botimi ka synuar të mbajë nën kontroll dy përmasa të rëndësishme që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe formën e tij.
Përmasa e parë është se ky botim përbëhet nga disa studime apo analiza që fokusohen në çështje të veçanta që kanë të bëjnë me marrëdhëniet mes shoqërisë dhe realitetit urban dhe trajton edhe instrumentet për zbbatimin e politikave urbane (Anila Gjika, Dritan Shutina); me planifikimin apo edhe reformimin e strategjive për planifikimin e territorit (Rudina Toto, Eriselda Cobo); me përpunimin dhe menaxhimin e mbetjeve urbane (Konalsi Gjoka); me ruajtjen e ekuilibrave mes politikave të shfrytëzimit të burimeve energjitike dhe marrëdhënieve të tyre me zhvillimin e turizmit (Redion Biba, Teida Shehi, Luca Jacopo Uberti); si edhe me dinamikat e zhvillimit rajonal (Rudina Toto, Iris Kuqi dhe Dritan Shutina).
Nga ana tjetër, veç meritës për të nxjerrë në pah disa tema prioritare, botuesit kanë bërë kujdes të veçantë për të respektuar një koherencë të brendshme të tekstit, duke i integruar analizat e veçanta në një të tërë që zotëron unitetin e vet metodologjik, përmbajtësor dhe redaktorial.
Nga kjo pikëpamje botimi Politikëndjekës apo Politikëbërës! mund të konsiderohet edhe si një studim tematik i integruar, por edhe si një përmbledhje me studime brenda një fushe me hapësira analitike të kryqëzuara apo të përafërta.
Sigurisht që kjo nuk lidhet vetëm me ndërlikueshmërinë e problematikave të marra në shqyrtim, por, besoj edhe me strategjitë e administrimit të kërkimit shkencor. Është e vështirë që një autor i vetëm të rrokë gamën e gjerë të çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin e territorit, ruajtjen e mjedisit, zhvillimin urban, dinamikat rajonale, etj. Shpesh kjo bën të domosdoshme punën në ekip dhe brenda këtij sistemi kërkon edhe krijimin e një koherence shkencore të ekipit, por edhe hapjen e horizonteve me qëllim që seicili nga autorët të ketë mundësi të shpalosë atë dije që atij i ka interesuar më tepër dhe ku ka më tepër kompetenca.
Me një fjalë, në këta lloje botimesh, vështirësia është se duhet administruar me qartësi dhe rendiment maksimal edhe ndërtimi i objektit të marrë në shqyrtim, por edhe ekipi, subjekti, që reflekton dhe analizon objektin e studimit. Janë dy proceseve që ndikojnë fort njeri tjetrin. Kjo vështirësi, më duket se është kapërcyer me sukses.

"Si zhvillimi i territorit,
ashtu si edhe politikat urbane
apo edhe dinamikat rajonale
në këta njëzet vjet të tranzicionit
shqiptar nuk është se shkëlqejnë.
Toka bujqësore e betonizuar..."

Një fjalë e dytë vjen medoemos për metodën që botuesit



" Pyjet e rrafshuara. Zona të tëra të pasura me burime energjitikefinanciare apo natyrore të braktisura. Një densitet i ekzagjeruar demografik në një ose dy qendra urbane metropolitane, t'a zemë në Tiranë, shoqëruar me zbrazjen e frikshme të territorit në periferi."

dhe autorët kanë kërkuar të respektojnë në këtë botim. Dallohen menjëherë konstatimet mbi të cilat ata nisen. Si zhvillimi i territorit, ashtu si edhe politikat urbane apo edhe dinamikat rajonale në këta njëzet vjet të tranzicionit shqiptar nuk është se shkëlqejnë. Toka bujqësore e betonizuar. Pyjet e rrafshuara. Zona të tëra të pasura me burime energjitike, financiare apo natyrore të braktisura. Një densitet i ekzagjeruar demografik në një ose dy qendra urbane metropolitane, t'a zemë në Tiranë, shoqëruar me zbrazjen e frikshme të territorit në periferi. Një harxhim pa hesap energjish të shtrenja që normalisht do të kishte qenë një luks për një vend ekonomikisht të varfër si Shqipëria, një mjedis urban i tejndotur nga zhurmat, mbetjet urbane, papastërtia e ajrit, etj.

Në fakt, janë probleme të modernitetit dhe autorët i kanë trajtuar si të tilla. Nuk paraqiten me të drejtë si aspekte shoqëruese të stagnacionit ekonomik, por të dinamikave ekonomike dhe shoqërore tepër të vrullshme të këtyre njëzet viteve të fundit.

Mesa kanë mundur autorët kanë mbajtur parasysh kërkesën e trajtesave të krahasuara me vende të tjera të rajonit ose më gjerë sesa kaq, ndonëse nuk do të ishte rënduar analiza e ndërmarrë nëse këto përqasje komparative do të kishin qenë edhe më të zgjeruara.

Nuk dallohet që midis autorëve të tekstit të ketë pasur debate apo kundërshti, nuanca, lidhur me trajtimin e çështjeve. Ndofta një debat mes tyre do t'a kishte bërë studimin në tërësi edhe më interesant akoma. Megjithatë ende në Shqipëri brenda një teksti me disa autorë nuk është zhvilluar sa duhet metoda e debatit dhe e perspektivave të nuancuara. Pavarësisht nga kjo, është merita e botimit që të gjitha çështjet që merren në shqyrtim, trajtohen me anët e tyre kontradiktore, me dilemat e tyre. Sigurisht zhvillimi urban nuk mund t'i shpëtojë filozofisë së rriskut, përqasjeve me doza të ndjeshme papërcaktueshmërie, anëve që ndodh që kundërshtojnë njera tjetrën.

Raporti mes trajtimit të mbetjeve urbane dhe kostos të kësaj industrie është një i tillë. Marrëdhëniet mes demokracisë lokale dhe zhvillimit të integruar rajonal – shfaqen poashtu si një funksion me ndërvartësira kontradiktore mes anëve të tij. E këtu spikat gjithashtu dilema mes zhvillimit të burimeve energjitike, politikave të menaxhimit me rendiment të flukseve të lëndëve energjitike dhe ruajtjes të mjedisit.


Ndofta pikërisht për këtë indikator të fundit do të kishte vend që të nxirreshin edhe më tepër në pah jo vetëm analiza që kanë të bëjnë studimin e strukturave përmbajtësore të realitetit, por edhe me një shqyrtim të hollësishëm të grupeve të presionit, të lobive, të aktorëve ekonomikë, të faktorëve ndërkombëtarë apo vendas që kanë strategjitë e tyre të zhvillimit, si edhe influencat e ndërsjella mes aktorëve ekonomikë dhe atyre politikë si shteti, partitë politike, personalitetet politike, etj.

Botimi Politikëndjekës apo Politikëbërës! të shtron pyetjen kur e lexon me kujdes : A përmban ai një analizë makro apo mikrosociale ? Pra, cila është shkalla e vrojtimit të dukurive sociale që kanë të bëjnë me tematikën e marrë në konsideratë? Mua më duket se përgjithësisht punimi qendron te një riprodhim "kartografik" i realitetit dhe shqyrtim serioz i tij në nivelin makrosocial, ose në një përmasë të ndërmjetme midis analizave cilësore kombëtare dhe atyre të kontekstualizuara në një këndvështrim më konkret dhe specifik në rang mjedisesh mikrosociale.

Duhet thënë se studimi përbën një risi në kërkimin shkencor dhe në botimet shqiptare. Kemi të bëjmë me një univers termash dhe mekanizmash, instrumentash planifikimi urban apo territori që janë relativisht të reja në përdorim në botën shqiptare.

Nuk është e lehtë të planifikosh në kushtet e një ekonomie tregu të lirë. Mirëpo mungesa e planifikimit të territorit si edhe të mirat të tjera publike që kanë dinamika dhe pasoja afatgjata zhvillimi, që nuk janë pronë private e askujt, por të mira publike të ndara mes qytetarësh të barabartë, dëmton jo vetëm tregun e lirë, por edhe barazinë e shtetasve përpara shanseve në jetë. Prandaj më është dukur shumë e drejtë që autorët e analizave në këtë botim përpiqen të mbajnë një ekuilibër metodologjik dhe botëkuptimor midis mekanizmave që rregullarizojnë disa marrëdhënie strategjike në administrimin e territorit nga ana e bashkësisë kombëtare ose bashkësive lokale dhe lirisë së sipërmarrjes së lirë apo të drejtës për zhvillim që e zotëron çdo subjekt ekonomik apo qytetar.

Si përfundim gjykoj se në botimin Politikëndjekës apo Politikbërës ! kemi një vëllim studimor me mjaft interes përsa i përket shqyrtimit të politikave dhe praktikave të administrimit të territorit, i cili jep mundësi për t'a zgjeruar spektrin e studimeve shqiptare në këto fusha.





MATRA
TRANSFORMIM SOCIAL



EXPO POLIS

& Promovimi i Partneriteteve për Qytetet e Mundësive te Përbashkëta

Më 8 Korrik 2010 Co-PLAN dhe Universitetit POLIS, lançuan fillimin e Projektit për "Promovimin e partneriteteve për qytetet e mundësive të përbashkëta" - Ngritja e kapaciteteve për planifikimin territorial gjithpërfshirës, si dhe Programi MASTER i Universitetit POLIS për çështjet e planifikimit të territorit dhe dizajnit arkitektonik e hapësinor.
Për rëndësinë që mbartin çështjet e planifikimit të territorit ky aktivitet u nderua me pjesëmarrjen e Kryeministrit të vendit Z. Sali Berisha, Ambasadorit të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta Z. Henk G.C. van den Dool, , Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Z. Myqerem Tafaj si edhe përfaqësues të IHS/Erasmus. Në fjalën përshëndetëse Z. Berisha theksoi rëndësinë e kualifikimit të mëtejshëm të specialistëve në nivel qendror e vendor, për çështje të planifikimit të territrorit, si një hap i rëndësishëm për zhvillimin e qendrueshëm të qyteteve tona. Gjithashtu Ambasadori Van den Dool shprehu mbështetjen maksimale dhe vlerësimin për bashkepunimin e deritanishëm me Co-PLAN dhe instutucionet vendore Shqipëtare duke siguruar mbështetjen e vendit të tij në projektet për qeverisjen e mirë urbane.
Ky projekt vjen si një iniciativë e Co-PLAN dhe IHS/Erasmus i mbështetur nga Qeveria Hollandeze në kuadër të Programit MATRA, duke u realizuar në bashkëpunim me Universitetin POLIS, Ministrinë e Punëve Publike (me AKPT), shoqatat e pushtetit vendor dhe me bashkitë e Durrësit, Shkodrës dhe të Fierit. Zbatimi i këtij projekti përkon në kohë me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të Planifikimt të Territorit, duke e bërë atë tejet konkret dhe shumë urgjente nevojën për aplikimin e modeleve të reja të planifikimit dhe manaxhimit të territorit nga njësitë e qverisjes vendore dhe autoritetet kombëtare që do të hartojnë legjislacionin dytësor. Projekti ka fokus kryesor rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e planifikimit, duke ofruar asistencë në punë për specialistët në nivel vendor dhe qendror, si edhe trajnime dhe kurse profesionale në nivel kombëtar të asistuara nga IHS/Erasmus dhe akredituara nga Universiteti POLIS si pjesë e programit MASTER. Lançimi i Programeve MASTER të Universitetit POLIS për çështjet e planifikimit të territorit dhe dizajnit arkitektonik e hapësinor, vjen si një risi në programin akademik të studimeve mbi arkitekturën dhe planifikimin urban në Shqipëri, duke kontribuar në politikat dhe kornizën ligjore të planifikimit të territorit në Shqipëri, në përputhje me direktivat e Bashkimit Europian.
Ky aktivitet u shoqërua me hapjen e ekspozitës së përvitshme Expo_POLIS, me punët e kërkimit shkencor dhe proçesit akademik, duke pasqyruar më së miri eksperiencën e punës në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe jashtë saj.

TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Tryezë Kombëtare mbi Taksën e Paluajtshme në Shqipëri

Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, dhe veçanërisht taksa mbi ndërtesën, e cila administrohet prej njësive të qeverisjes vendore, është aktualisht një burim i pashfrytëzuar të ardhurash. Ndonëse Parlamenti, që nga viti 2003, rriti përqindjen e taksës së pasurisë që i kalon pushtetit vendor në 100%, efiçienca në mbledhjen e taksës mbi pasurinë e paluajtshme është e ulët: kjo taksë kontribuoi vetëm 5% në të ardhurat e pushtetit vendor në 2007, ekuivalente me 3 USD për person, ose rreth 0.1% e PBB-së. Kjo performancë e ulët vjen nga fakti se ekzistojnë ende shumë dobësi administrative për menaxhimin e kësaj takse në nivel menaxhimi vendor, gjë e zakonshme në ekonomitë në tranzicion. Efiçenca në grumbullimin e taksës është e ulët. Kjo është evidente në të ardhurat e mbledhura: jo më tepër se 50% e asaj që pritet.

Më 21 Tetor, Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në kuadër të Programit për Qeverisjen Vendore në Shqipëri financuar nga USAID dhe “Ndikimi në Politikëbërje” financuar nga Instituti për Shoqërinë e Hapur – OSI, Budapest prezantoi gjetjet dhe rekomandimet e studimit kërkimor “Taksa e Pasurisë së Paluajtshme – Instrument Inovativ për rritjen e të ardhurave vendore” në një tryezë bisedimesh me përfaqësues të njësive të qeverisjes vendore, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Brendshme, Zyrës së Rregjistrimit të Pasurive, dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

Studimi eksploron alternativa inovative të cilat mund të përdoren nga Njesitë e Qeverisjes Vendore (NJQV-të), si instrumenta për përmirësimin e financave të tyre për të përballuar nevojat në rritje për investimeve ne infrastrukturë

Studimi përshkruan gjithashtu rolin potencial të taksës mbi pasurinë e paluajtshme si një mjet i rëndësishëm rregullues në procesin e administrimit të tokës dhe ndërtesës. Për të arritur këto objektiva, studimi rekomandon ndryshime në legjislacionin ekzistues për tatimin mbi pasurinë e paluajtshme, dhe një koordinim më të mirë të politikave fiskale me politikat e zhvillimit të tokës dhe planifikimit urban.







FORUM URBAN



FORUMI URBAN

Manaxhimi i Mbetjeve të Ngurta

Manaxhimi i mbeturinave të ngurta ka arritur të përbëjë një nga problemet më të rëndësishme në agjendën mjedisore në Shqipëri, me një impakt të rëndësishëm social dhe ekonomik. Realiteti me të cilin përballemi sot, vjen si pasojë e përpjekjeve të pamjaftueshme, veprimeve të pakoordinuara dhe si pasojë rezultate të dobta. Shërbimi i manaxhimit të mbetjeve të ngurta ofrohet dhe subvencionohet në pjesën më të madhe nga pushteteti lokal, të cilat hedhin poshtë- konceptin 'ndotësi paguan'.

Sistemi i grumbullimit të mbetjeve lë për të dëshiruar me disa zhvillime dhe arritje modeste: kontenierë për grumbullimin e mbetjeve të pa diferencuara janë të vendosur përgjatë rrugëve, dhe iniciativa si riciklimi pothuajse nuk ekzistojnë. Të gjitha mbetjet transportohen në fushë depozitimesh, të cilat janë shumë pranë zonave suburbane në kundërshtim të plotë me rregullat mjedisore.

Ky lloj manaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane, jo në përputhje me rregullat dhe standardet mjedisore ka sjellë shqetësimin tek pushteti vendor, i cili më pas është reflektuar në hartimin e draftit të Strategjisë Kombëtare të Mbetjeve, dhe pothuajse një Plan Kombëtar për Manaxhimin e Mbetjeve. Dy objektiva të rëndësishëm dominojnë Strategjinë Kombëtare për manaxhimin e mbetjeve:

(i) Rritjen e sasisë së mbetjeve për t'u ricikluar dhe kompostuar me 25% deri në vitin 2015, dhe
(ii) Me 55% deri në vitin 2020

Në kuadër të kësaj situate, Co-PLAN në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, dhe me pjesmarrjen e NJQV-ve organizuan Forumin Urban "Relaiteti Vendor kundrejt Strategjisë dhe Planit Kombëtar të Mbetjeve, me qëllimin për të kontribuar në debatin kombëtar se si NJQV-të munden të përballojnë kostot e manaxhimit të mbetjeve.

TRANSFERTAT NDËRQEVERITARE

Si Rrjedhin të Ardhurat Vendore nga Burimet Kombëtare ?

Prej disa vitesh Co-PLAN është përfshirë në çështjet e Financave Publike, duke u konsoliduar kryesisht në manaxhimin e financave bashkiake. Me mbështetjen e çmuar të donatorëve, të tillë si OSI – Hungari, USAID, dhe Fondacioni Soros, Co-PLAN ka bashkëpunuar me njësi te shumta të qeverisjes vendore në Shqipëri duke synuar përmirësimin në financat bashkiake.
Manaxhimi i financave bashkiake përbën një çeshtje të ndjeshme në Axhendën Politike Shqiptare, si rritja e investimeve kapitale, dhe manaxhimi i buxhetit të qeverisë vendore. Nëse do të pranonim se, të ardhurat nga njësitë e qeversijes vendore duhet të konsolidohen, debati mbi transferta ndërqeveritare bëhet një pjesë e pandarë e të gjithë performancës së fianancave vendore. Edhe pse një kundër- praktikë në proçesin e decentralizimit, qeveria vendore mbetet e varur nga qeveria qëndrore për transfertat(e fondeve), të cilat nuk shënojnë as 50% të të gjithë buxhetit të qeverisë vendore.
Prandaj, hartimi i transfertave është me rëndësi kritike në suksesin e proçesit të decentralizimit. Edhe pse alokimi i transfertave ndërqeveritare ka qenë disi 'i percaktuar' ka ende disa debate për t'u trajtuar sidomos *Grantet Konkuruese*, të njohur si të tillë që në vitin 2010, kohë ne te cilen u prezantua dhe Fondi i Zhvillimit Rajonal.

Brenda këtij kuadri Co_PLAN, Instituti per Zhvillimin e Habitatit, mbeshtetur nga *Local Government and Public Service Reform Initiative* (LGI) Budapest, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave , organizuan tryezën e rrumbullakët " Sistemi iTransfertave Ndërqeveritare në Shqipëri --- Si të ardhurat vendore derivojnë nga të ardhurat qëndore?!"
Qëllimi i tryezës së rrumbullakët ishte të gjeneronte një debat konstruktiv për të fituar një kuptim të përgjithshëm të gjendjes aktuale të sistemit te transfertave ndërqeveritare në Shqipëri, duke u fokusuar në impaktin që politika ka mbi ta, dhe për të tërhequr vëmendjen në lidhje me kriteret e nevojshme për të përcaktuar të ardhurat vendore të cilat rrjedhin nga burimet kombëtare.
Tryeza e rrumbullakët mblodhi së bashku zyrtarët e nivelit të lartë nga qeveria vendore, përfaqësues nga Ministria e Financave, nga Ministria e Mbrojtjes, dhe përfaqesues nga institucionet donatorë, të tillë si Fondi Shqiptar i Zhvillimit, DEBASCON, DELTA projektet/LGI, LGPA/USAID, dhe DLDP/Bashkëpunimi Zviceran.





RICIKLIMI **I MBETJEVE**





RICIKLIMI I MBETJEVE

Përmirësimi i Performancës Mjedisore në Qeverisjen Vendore - Bashkia Fier

Në kuadër të projektit EELGP (Përmirësimi i Performancës Mjedisore në Qeverisjen Vendore duke marrë si pilot manaxhimin e mbetjeve të ngurta në Bashkinë Fier), u zhvillua aktiviteti për promovimin e investimeve në infrastrukturën për përmirësimin e shërbimit të manaxhimit të mbetjeve të ngurta urbane. Aktiviteti u hap në Bashkinë Fier, ku morën pjesë Ambasadori i Mbretërisë së Vendeve të Ulta, Kryetari i Bashkisë Fier, përfaqësues të Co-PLAN, zyrtarë të bashkisë, dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Më pas aktiviteti vijoi në sheshin kryesor të qytetit 'Nënë Tereza', ku u përuruan blerja e dy makinave të reja teknologjike për grumbullimin e mbetjeve nga Ndërmarrja e Pastrimit në Bashkinë Fier. Vizita vazhdoi në Bllokun Pilot të Riciklimit, në lagjen '8 Shkurti' të qytetit ku ishte vendosur sistemi i ri i grumbullimit të diferencuar të mbetjeve - sistemi me tre kosha. Të ftuarit vizituan çadrën e riciklimit, ku u zhvillua fushata sensibilizuese, u shpërndanë fletëpalosje, çanta, bluza, kapele, dhe libra. Aktivitetet u përmbyllën me dy vizita në një nga shkollat 9 vjeçare të qytetit, ku ishte vendosur sistemi i grumbullimit të mbetjeve të riciklueshme me katër kosha dhe në fund me përurimin e qëndrës së re të transferimit të mbetjeve, ku u demonstrua dhe ndarja e mbetjeve.

INSTRUMENTET FINANCIARE AFATMESME

Sfida e Investimeve Kapitale në Nivel Vendor

Tryeza Kombëtare: Qeverisja vendore dhe Instrumentet Financiare Afatmesme – Si te veprojmë me sfidën e Investimeve Kapitale në nivel vendor?!

Një tipar dallues në aktivitetin e Co-PLAN në prag të transformimit të ethshëm urban, është bashkëpunimi i ngushtë dhe përvoja që ka fituar në punën me qeveritë vendore në Shqipëri. Një bashkëpunim i tillë ka përfshire projektet në strategjinë e zhvillimi të qytetit, planet rregulluese urbane , dhe së fundmi çështjen e pregatitjes së buxhetit afatmesëm (MTBP). Ky i fundit ka ndërtuar një rrjet të gjerë e kompleks problemesh me të cilat përballet qeveria vendore, shumica e tyre në lidhje me të ardhurat e pakta vendore në krahasim me nevojat e tyre për investimet kapitale në infrastrukturen fizike dhe sociale. Në fakt, nga standardet europiane, shpenzimet e qeverisë vendore Shqiptare(buxheti) është relativisht i ulët, edhe si GDP dhe shpenzimet e qeverisë qendrore në përqindje, të cilat çojne në shifra konfliktuale teksa kërkesat e qytetarëve për shërbime më të mira dhe cilësisë së jetës janë në rritje. Ligji per menaxhimin e sistemit buxhetor në Shqipëri miratuar në vitin 2008, i kërkon qeverive vendore të përgatisin buxhetin afat-mesëm në përputhje me qeverinë qendrore në mënyrë që të lejojë planifikimin dhe integrimin në strategjitë e qeverisë. Një ndryshim i tillë ishte penguar nga ligji, nga të metat e ligjit në nivel zbatimi, dhe mungesa e trajnimeve, duke e bërë të pamundur për qeverisjen vendore respektojë afatin e fundit për MTBP, në vitin 2009. Në këto rrethana, disa qeveri vendore kanë kërkuar ndihmë nga donatorët për të përgatitur programin e investimeve kapitale në funksion të zhvillimi të rrjetit të infrastrukturës.
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitat organizoi një tryezë të rrumbullakët mbi qeverisjen vendore dhe Instrumentat Financiarë Afatmesëm dhe sfida që vjen nga investimet kapitale në qeverisjen vendore. Qëllimi i tryezës së rrumbullakët ishte tëgjeneronte një debat konstruktiv dhe ide të qarta se si ti përgjigjemi nevojave në rritje të qeverive vendore në projekte për financimin e investimeve kapitale; dhe lançimin e një projekti të ri i cili zbatohet nga Co-PLAN në bashkëpunim me Ministrinë e Financave. Projekti për përgatitjen e projektit afatmesëm është financuar nga LGI/OSI Budapest, dhe synon të mbështesë qeverinë vendore, por gjithashtu edhe qeverinë qëndrore në krijimin e një praktike të sukseshme lidhur me pergatitjen e instrumenteve financiare afatmesme.



OPEN HOUSE

Periphery is where I'm not









JAVA ARKITEKTURORE NE SOFJE

Periferia është Vendi ku Unë nuk Jam...




Viti 2010 shënoi edicionin e tretë të javës arkitekturore në Sofia, Bullgari, duke u hapur më 15 tetor, 2010. Veprimtaria mikpriti një përzgjedhje të folësve nga vende të krahasueshme me Bullgarinë, për nga niveli gjeografik dhe historik. Fokusi i këtij edicioni ishte vendosur në periferi, duke inkurajuar interpretime të ndryshme në kontekstin arkitektonik.
Co-PLAN mori pjesë në aktivitet, dhe mbajti një prezantim mbi Zhvillimin e Paplanifikuar Urban duke u fokusuar në përvojën shqiptare gjatë 1990-2010.
Tema e edicionit të Shtëpisë së Hapur për këtë vit ishte "Periferia është vendi ku unë nuk jam", dhe paraqiti pesë ekspozita. Shtëpia e Hapur i dedikoi Shqipërisë një diskutim mbi "Nga zero në Hero". Co-PLAN u angazhua në një seri aktivitetesh gjatë javës, duke përfshirë në biseda të shumta në radion kombëtare të Bullgarisë.

SOFIA
ARCHI
TECTURE
WEEK
2010

SISTEMET E MANAXHIMIT MJEDISOR

EMAS easy - Rasti në Bashkinë e Fierit.


Manaxhimi i mbetjeve të ngurta në Shqipëri, është një kompetencë e njësive të qeverisjes vendore, si pjesë e shërbimeve publike të deleguara njësive lokale (bashkive dhe komunave). Delegimi i kompetencave nuk u shoqërua me parashikimin e zhvillimeve të standardeve mjedisore, por vetëm me kalimin e këtyre shërbimeve nga niveli qendror në atë lokal. Që nga ky moment, njësitë lokale ofrojnë këto shërbime pa standarde duke shkaktuar në të njëjtën kohë ofrimin e shërbimeve jo cilësore për qytetarët dhe vështirësi në monitorimin e tyre.
Sistemet e Manaxhimit Mjedisor janë skema vullnetare që ju vijnë në ndihmë kompanive private dhe publike për të vlerësuar, raportuar dhe përmirësuar performancën mjedisore gjatë zhvillimit të aktiviteteve të tyre. Aktualisht sot ekzistojnë sisteme të ndryshme të manaxhimit mjedisor, ku ndër më të njohurit mund të përmendim ISO 14001, EMAS, EMAS easy etc.
Qëllimi i kësaj iniciative ishte prezantimi i sistemeve të manaxhimit mjedisor duke pilotuar një nga këto sisteme si EMAS easy në Ndërmarrjen e Pastrimit në Bashkinë Fier. Me anë të zbatimit të këtyre sistemeve ne kërkonim të arrinim objektivin për ofrimin e shërbimit të manaxhimit të mbetjeve sipas standardeve të certifikuara mjedisore.
Ku proçes u asistua gjatë zhvillimit të tij nga Co-PLAN dhe ekspertë të huaj. Procesi u zhvillua në harkun kohor prej 6 muajve ku u përfshinë: vlerësimi fillestar mjedisor i aktiviteteve që kryen ndërmarrja dhe zonat ku ajo i zhvillon; përcaktimi i objektivave mjediosre për përmirësimin e performancës mjedisore, të cilat duhet të realizoheshin brenda 6 muajve; hartimi i Deklaratës së parë Mjedisore e firmosur nga Kryetari i Bashkisë dhe më pas e bërë publike për komunitetin e gjërë; faza e zbatimit të objektivave, e cila u shoqëruar me auditime të brendshme dhe marrjen e masave korrigjuese. Ky proces përfundoi me certifikimin e Ndërmarrjes së Pastrimit në Bashkinë Fier, me standardin ndërkombëtar mjedisor ISO 14001, i cili është i pari i këtij lloji në Shqipëri. Dinamika e procesit është përmbledhur në mënyrë grafike në skemën EMAS easy (faqe 48).







ARCHIS
SEE NETWORK
SEE2010



RRJETI ARCHIS SEE 2010

Një Rrjet i Iniciativave te Pavarura Urbane në Europën Juglindore

Ndërmarrjet vendore tani mund të përfitojnë nga shkëmbimi i njohurive dhe praktikave më të mira, të rëndësishme në axhendën e debatit ndërkombëtare për urbanistikën nëpërmjet rrjetit Archis. Ky i fundit vepron në Evropën Juglindore (EJ) dhe ka për qëllim të nxisë rritjen e stimujve vendorë nëpërmjet njohurive dhe shkëmbimit të përvojave.
Seminari i Archis SEE Network për 2010 u mbajt në Split, Kroaci, dhe ishte një vazhdim i seminarit të mëparshëm "Vija bregdetare e Adriatikut", të mbajtur në Kotorr në vitin 2009.
Fokusi i seminarit u vendos në shqyrtimin e karakteristikave të turizmit në të gjitha vendet partnere (Kroacia, Mali i Zi dhe Shqipëria - vende partnere shtesë do të përfshihen nëse është e nevojshme), në mënyrë që të përftojmë një set informacionesh dhe vlerash krahasuese të cilat lidhin rrethanat përgjatë bregut të Adriatikut. Nëpërmjet mbledhjes dhe diskutimit instrumentave statistikore, seminar kishte për qëllim identifikimin e tendencave të lidhura me zhvillimin.
Në ndjekje të "identifikimit të praktikave" qëllimi i dytë i seminarit ishte për të parë në tema të veçanta dhe problematike të saj në vende të caktuara, në bazë të informatave dhe përvojave të organizatave. U konstatua se, fenomene të caktuara urbane dhe kulturore të veçanta në një vend, mund t'i bejë jehonë zhvillimeve politike dhe ekonomike në një vend tjetër; të tilla ishin rastet e zhvillimit të vendeve me regjim ish-ushtarake dhe me infrastrukture të braktisur, e përbashkët për të dy Kroacinë dhe Shqipërinë, dhe çështja e vendbanimeve informale dhe zhvillimit të paligjshëm përgjatë bregdetit. Një tjetër realitet post-socialist në Evropë përbën çështja e sigurisë dhe e pronës private kundrejt interesit dhe të mirës së shoqërisë.

Një dokument adresuar gjendjes së artit në zhvillimet e turizmit përgjatë bregdetit Adriatik është hartuar dhe aktualisht është në pregatitje.Ky dokument përbën produktin kryesor të këtij seminari, dhe është parashikuar të përdoret si një burim kryesor pikënisjeje, për të përgatitur një propozim të përbashkët të projektit.



PROJEKTE

12

- PROMOVIMI I PARTNERITETEVE TË QYTETEVE PËR MUNDËSI TE PËRBASHKËTA
- NDIKIMI NË POLITIKËBËRJE
- PËRMIRËSIMI I PERFORMANCËS MJEDISORE NË QEVERISJEN VENDORE
- EFIÇIENCA E ENERGJISË
- INSTRUMENTET FINANCIARE AFATMESME
- LIGJI PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT
- TRANSFERTAT NDËRQEVERITARE
- TAKSA E PASURISË - NJË INSTRUMENT PËR TË ORJENTUAR ZHVILLIMIN
- LOGIN - RRJETI I INFORMACIONIT MBI QEVERISJEN VENDORE
- HARTIMI I PLANIT TË PERGJITHSHËM RREGULLUES KUKËS & FUSHË - KRUJË

PROMOVIMI I PARTNERITETEVE PËR QYTETE TË MUNDËSIVE TË PËRBASHKËTA

Koha e Zbatimit: 2010 - 2013
Donatori: Qeveria Hollandeze nëpërmjet MATRA
Fondi: € 174, 652
Zbatohet ne: Fier, Durrës, Shkodër, Tiranë

Prej Majit të 2010, Co-plan është angazhuar në zbatimin e projektit "Promovimi i Partneriteteve për Qytetet e Mundësive të Përbashkëta – Ngritja e Kapaciteteve për Planifikimin Territorial Gjithpërfshirës" i mbështetur nga qeveria Hollandeze nëpërmjet programit MATRA në Shqipëri. Projekti po zbatohet në bashkëpunim me IHS - Instituti për Strehimin dhe Zhvillimin Urban të Roterdamit (Hollandë), Universitetin Polis, Ministrinë e Transportit dhe Punëve Publike (në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit), shoqatat e njësive vendore, dhe bashkitë e Shkodrës, Durrësit dhe Fierit.
Ky projekt ka si qëllim përmirësimin kapaciteve planifikuese në nivel vendor dhe qendror në fushat e planifikimit urban dhe zhvillimit të qendrueshëm.
Zhvillimi hapsinor i qendrueshëm është principi kryesor i projektit i cili kontribuon në:
Krijimin e një kohezioni ekonomik dhe shoqëror;
Ruajtjen e burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore;
Promovimin e konkurrencës ekonomike;

Komponentët kryesorë të projektit janë:
Promovimi i planifikimit me pjesmarrje nga aktorët kryesorë në zona me prioritet zhvillimi në bashkitë e Shkodrës, Fierit dhe Durrësit, duke përkrahur partneritetet publike dhe private, për mundësimin e krijimit dhe zbatimit të instrumentave për kontrollin e zhvillimit të territorit.
Ngritja e kapaciteteve dhe përhapja e njohurive për zhvillim hapësinor të qendrueshëm në të gjitha nivelet, duke u fokusuar në stafet e njësive vendore, institucioneve qendrore dhe profesionistëve.
Mundësimin e një koalicioni për zhvillimin e politikave dhe instrumenteve në çështjet e administrimit dhe planifikimit territorial, në mënyrë që të ndikojë në politikat dhe kornizën ligjore të planifikimit në përputhje me direktivat e BE-së.

TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

1 Promovimi i planifikimit me pjesmarrje

- Identifikimi dhe vlerësimit nevojat ne secilin prej zonave te Shkodrës, Durrësit dhe Fierit.
- Firmosja e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me sejcilën prej bashkive;
- Krijimi i grupeve të punës në çdo bashki për zbatimin e projektit, me role dhe përgjegjsi te qarta.
- Grupet e punës përbëhen nga stafi i bashkive dhe Co-planit.
- Identifikimi i zonave për zbatimin e projektit në Shkodër, Durrës dhe Fier;
- Përcaktimi dhe miratimi i tre zonave (një për sejcilën bashki).

2 Ngritja e kapaciteteve dhe përhapja e njohurive për çështjet e planifikimit të territorit

- Promovimi i praktikave të zhivillimit të qendrueshëm hapësinor nëpermjet faqeve të internetit egzistuese (Co-PLAN, POLIS, LOGIN and IHS).
- Përhapja e njohoruive mbi zhvillimin hapsinor të qendrueshëm në Shqipëri nëpërmjet faqeve të internet të Co-plan dhe Polis.

3 Formimi i një koalicioni për zhvillimin e politikave dhe instrumenteve.

- Shqyrtimi i udhëzimeve të BE-së dhe kërkesave të PSA në lidhje me impaktin e tyre në zhvillimin hapësinor të qendrueshëm në Shqipëri.
- Analizimi i udhezimeve të BE-së dhe kërkesat e Paktit për Stabilizim dhe Asocim m Shqipërine, si dhe implikimet e tyre në zhvillimin hapsinor të qendrueshëm.
- Përgatitja e një udhëzimeve që ofrojnë të dhëna mbi përputhjen e legjislacionit mbi planifikimin e territorit me udhezimet e BE-se.




PROJECTS
SYNERGY
PROFESSIONALISM
GROWTH

NDIKIMI NË POLITIKËBËRJE

Koha e Zbatimit: 2010 - 2013
Donatori: Instituti për Shoqërinë e Hapur, OSI, Budapest
Fondi: Per 2009 - 2010 $ 65. 000
Zbatohet në: Shqipëri

Viti 2010 shënoi rritje të mëtejshme në njësinë e Punës Kërkimore të aplikuar për Politika qendrore e locale, e cila u prezantua suksesshëm në Co-PLAN për të tretin vit rresht. Kjo iniciativë kërkimore, e filluar si pjesë e projektit 'Punë Kërkimore të Aplikuar për Politika Publike- Ndikimi i Politikëbërjes', është shndërruar në një pioniere për sa i takon traditës së punës kërkimore për politika publike në Shqipëri, dhe kontributit cilësor e sasior.
Sikurse në dy vitet e shkuar, viti i tretë dhe i fundit i këtij programi u mbështet nga Open Society Institute in Budapest, dhe SOROS Think Tank Fund (TTF), dhe e gjeti Co-PLAN të angazhuar me dy qëllime të qarta:

Përforcimi i kapaciteteve të brendshme në fushën e projekteve kërkimore, dhe

Aplikimi i rezultateve të studimit të politikave me synim ndikimin e zhvillimit dhe zbatimit të tyre.

Për sa më lart, ato përbëjne pjesë të pandashme të aspiratës së Co-PLAN për të thelluar aftësine dhe kapacitetin për të kryer punë kërkimore të politikave publike, përfshirë këtu publikime akademike e politikash, bashkëpunim me qëndra të afirmuara jashtë shtetit, dhe njohjen e Co-PLAN si një Think Tank.
Aktualisht, Co-PLAN beson se është në rrugën e duhur, tek sa konsolidon imazhin e saj si një qëndër e mirënjohur kërkimore dhe ndikuese në fushën e politikave publike, sin ë nivel akademik ashtu dhe në nivel qeveritar. Për të inkurajuar rritjen e vazhdueshme si një institut kërkimor, gjatë vitit 2010 Co-PLAN zgjeroi më tej portofolin e saj te punës kërkimore, përshtati atë ne përputhje me zhvillimet më të fundit të politikave në Shqipëri, si dhe bashkëpunimin me partnerët e saj, kryesisht me U_POLIS.
Ne besojmë se aktivitet janë instrumenta thelbësorë në ndikimin e politikave publike të momentit në Shqipëri, gjë që shpjegon dhe arsyen e intensifikimit të tyre gjatë vitit 2010.

TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

1 Përditësim i axhendës së punës kërkimore, duke u thelluar në disa tema aktuale, dhe prezantuar tema të reja me interes për punë kërkimore dhe rekomandime.

- Eshtë përfunduar studimi mbi dy punë kërkimore ne çështjen e taksës mbi pronën e paluajtshme dhe transfertave ndërqeveritare, gati për botim në fillim të vitit 2011.
- Fokusi për 2010 u vendos në nëntë fusha kërkimore, ku përfshihen temat e administrimit urban, rajonal, e mjedisor dhe financat bashkiake.
- Identifikimi dhe adresimi i nevojës për 'advocacy' në axhendën punës kërkimor në Co-PLAN.

2 Fuqizimi i grupit të punës kërkimore në Co-PLAN, dhe rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të brendshme për punë kërkimore, analizë, formulim dhe shpërndarje për ndikim maksimal të mundshëm.

- Një total prej 67 titujsh të rinj iu shtuan koleksionit të librave dhe anëtarësia me Shoqatën e Studimeve Rajonale u rinovua për vitin në vazhdim.
- Ekspertë të Co-PLAN morrën pjesë në një seri aktivitetesh ndërkombëtare, përkatësisht ne Austri, Kroaci, Itali, Hollandë dhe Serbi.
- Gjashtë punonjësve të Co-plan iu ofrua mundësia për të ndjekur studimet në fushën Te Manaxhimit Urban, ne nivelin Master ne U_POLIS.
- Sinergjia (lidhja) Co-PLAN – U_POLIS u forcua më tej në nivel kërkimor dhe organizativ dukë qënë se të dyja palët ndajnë ambiente të reja të përbashkëta pune, në Kashar, Tiranë.
- Vlerësimi i Co-PLAN nga OSI TTF në Korrik 2010, nënvizoi aftësitë premtuese në fushën kërkimore dhe domosdoshmërinë e menjëhershme për përfshirje në ndikimin e politik-bërjes.
- Rekomandime për përmirësime të kapacitetit në nivel organizate, aftësi të stafit, dhe partneriteteve productive do të prezantohen në një raport të detajuar ' Plani Strategjik i Co-PLAN' në Shkurt 2011.
- U miratua propozimi i ri për vazhdimësinë e 'Ndikimi Politikëbërjes II' 2010-2013 nga TTF OSI, Budapest.



TREGUESIT E ARRITJES & OBJEKTIVAT

3 Përcaktimi i disa temave politikash publike për ndikim dhe përmirësim, duke intensifikuar aktivitete me ndikim në politika dhe duke përditësuar strategjinë përkatëse për periudhën 2009-2010.

- Nga nëntë tema nën studim, u kompletuan shtatë dokumenta politike, që mbulojnë te tre fushat e ekspertizës së Co-PLAN.
- 'Politikëndjekës apo Politikëbërës' përbën dhe titullin më të ri të publikuar nga Co-PLAN në Dhjetor 2011. Libri, i cili përmban dymbëdhjetë dokumenta politikë të përzgjedhura, do të përurohet në vitin 2011.
- Janë mbajtur katër tryeza kombëtare në kuadër të debatit të decentralizimit, menaxhimit të mbetjeve të ngurta, taksës mbi pronën e paluajtshme dhe programit të buxhetit afat-mesëm në nivel local.
- Filloi procesi i pjesëmarrjes për përpilimin e akteve nënligjore të Planifikimit të Territorit, nëpërmjet diskutimeve në katër tryeza rajonale me njësitë vendore dhe grupet e konsulencës.
- Rregulloret ju dorëzuan Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit në Nëntor 2010.
- U publikua metodologjia EMAS dhe modeli për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel local, dhe u shpërnda në një tryezë kombëtare te mbajtur në Dhjetor 2010.
- U krye puna në terren për dokumentin e politikave mbi PBAM, dhe u prodhua metodologjia dhe modeli përkatës, të cilat u diskutuan më tej në një tryezë kombëtare.

PËRMIRËSIMI I PERFORMANCËS MJEDISORE NË QEVERISJEN VENDORE

Koha e Zbatimit: Dhjetor 2008 - Dhjetor 2010
Donatori: Ambasada e Vendeve te Ulëta
Fondi: € 467,282
Zbatohet në: Bashkinë Fier

Procesi i decentralizimit është thelbësor në përmirësimin e shërbimeve publike; eksperienca ka treguar që delegimi i përgjëgjësisë autoriteteve lokale motivon sektorin publik të jetë më i ndjeshëm ndaj nevojave të individëve. Në Shqipëri, ashtu si edhe në vendet e Europës Lindore, përgjegjësia për ofrimin e shërbimit të manaxhimit të mbetjeve i është deleguar NJQV-ve, ndonëse niveli i standardeve të ofrimit të shërbimit duhet të përcaktohet ende; kjo ka çuar në hasjen e vështirësive në financim dhe monitorim të shërbimit dhe në degradim të mëtejshëm të kushteve të mjedisit duke paraqitur një rrezik më të madh në shëndetin e njerëzve.
Duke marrë në konsideratë këtë situatë, Co-PLAN prezantoi dhe zbatoi në Bashkinë Fier projektin EELGP. Projekti kishte si qëllim të prezantonte Sistemet e Manaxhimit Mjedisor duke pilotuar skemat EMAS easy në Ndërmarrjen Bashkiake të Pastrimit në Bashkinë Fier.

Me anë të zbatimit të këtyre skemave, NJQV-ve do të kenë mundësinë të testojnë standadet mjedisore të certifikuara dhe të propozojnë këto standard në nivel qendror drejt proceseve të standardizuara me qëllimin final për të plotësuar boshllëkun që ekziston në kuadrin ligjor mjedisor.
Gjatë periudhës së zbatimit, ky projekti influencpoi në hartimin dhe përgatitjen e Planit Lokal të Manaxhimit të Mbetjeve në qytetin e Fierit.
Eksperienca e marrë gjatë këtij procesi është ndarë në shumë tryeza të rrumbullkata që janë organizuar në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, si dhe me anë të publikimeve të ndryshme.
Ne besojmë se ky projekt prodhoi një model të mirë për autoritet lokale dhe njëkohësisht një asistencë në hartimin e politikave lokale në përputhje me planin kombëtar dhe legjislacionin ekzistues të manaxhimit të mbetjeve.

TREGUESIT E ARRITJES & OBJEKTIVAT

1 Përmirwsimi i performancës sw manxhimit mjedisor të Ndërmarrjes sw Pastrimit dhe Drejtorisë të Shërbimeve Publike në Bashkinë Fier

- Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit dhe ngritja e infrastruktures se punes
- Organizimi i takimit të parë me bordin këshillues dhe prezantimi i mbi situaten aktuale dhe realizimi i një studimi fillestar mjedisor
- Kryerja e nje numer studimesh analitike institucionale dhe sociale, dhe e njw auditimi financiar të Ndërmarrjes Pastrimit për vlerësimin e efiçiencës
- Prezantimi i sistemeve të manaxhimit mjedisor EMAS easy për t'u zbatuar nga Ndërmarrja e Pastrimit në Bashkinë Fier

2 Përmirwsimi i shërbimit ekzistues të Manaxhimit të Mbetjeve të Ngurta në Bashkinë Fier duke ndërtuar një strategji dhe një plan veprimi për të ardhmen

- Organizimi i katwr seminareve dhe trainimeve me grupin e punws, dhe fushatws sensibilizuese me popullatwn
- Pwrcaktimi i metodologjisw pwr tu pwrdorur dhe prezantimi me sistemin e menaxhimit mjedisor EMAS easy;
- Studimi i aktivitetit tw pwrditshwm nw Ndwrmarrje, dhe përcaktimi i objektivave për përmirësimin e performancës mjedisore dhe hartimi i Vizionit, Misionit, dhe Objektivave të Planit Strategjik të Mbetjeve të Ngurta Urbane
- Kryerja e një auditimi të brëndshëm, për matjen e ecurisë së zbatimit të objektivave mjedisorë dhe përcaktimin e masave parandaluese
- Pwrgatitja dhe publikimi i Deklaratws se Parë Mjedisore, zhvillimi i procesit të auditimit dhe çertifikimi i Ndërmarrjes
- Pastrimit në Bashkinë Fier me standardin ndërkombëtar për mjedisin ISO 14001



TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

3 Shpërndarja e eksperiencave të fituara pwr inkurajimin e njësive të tjera të qeverisjes që të minimizojnë e ndikimet në mjedis të aktivitetit të tyre

- Organizimi i dy Tryezave Kombëtare mbi sektorin e manaxhimit të mbetjeve për identifikimin, adresimin e çështjeve problematike aktuale, dhe aftësive tw autoriteteve vendore për të përballuar kostot e proçesit
- Organizimi i seminarit mbi Studimin e ndarjes së Mbetjeve për të përhapur më tej rëndësinë e procesit të ndarjes së mbetjeve dhe gjetjet e studimit mbi ndarjen e tyre
- Botimi i 3 artikujve në gazetat “Ekolëvizja” dhe “Mjedisi Sot” dhe zhvillimi i fushatave sensibilizuese dhe educative për promovimin dhe njohjen me sistemin e ri të grumbullimit të mbetjeve me tre kosha

4 Përmirësimi i infrastrukturës për përmirësimin e shërbimit të mbetjeve të ngurta urbane nëpërmjet investimeve konkrete të bashkëfinancuara nga bashkia

- 3 takime u realizuan me grupin e punës për identifikimin e fushave që kanë nevojë për ndërhyrjet në infrastrukturë
- 1 analizë finaciare e detajuar është kryer dhe janë nxjerrë përfundimet lidhur me fushat ku do të kryhen investimet

EFIÇIENCA E ENERGJISË NË BANESA

Koha e Zbatimit: 2009 - 2011
Donatori: Komisioni Europian
Fondi: € 99, 497
Zbatohet në: Bashkinë Fier

Sektori i banesave është një nga konsumatorët kryesorë të burimeve energjitike në Shqipëri. Niveli i konsumit të energjisë nga sekroi i banesa, në vitin 2005 arriti shifrën 27% ndaj kërkesës për energji që shënoi shifrat 60%. Shqipëria është një vend mesdhetar dhe pjesa më e madhe e ndërtesave të banimit ose janë të patermoizoluara ose karakterizohen nga një izolim i lehtë i mureve të jashtme dhe tarracës/ çatisë dhe dritare me një xham.
Për vite me rradhë bashkitë nuk kanë qënë në gjendje që të adresojnë konsumin e energjisë në sektorin e banesave si pasojë e mungesës së kompetencave dhe instrumentave të duhur. Pas viteve '90, përgjegjësia për mirëmbajtjen e ndërtesave të banimit u bë një koncept që për banorët nuk kishte më kuptim të përsonifikohej me një entitet apo person të veçantë, kjo edhe për faktin se kontratat e privatizimit të apartamenteve nuk u shoqëruan nga një klauzolë , e cila specifikonte edhe çështjen e mirëmbajtjes të pjesëve të përbashkëta.
Megjithatë, këto vitet e fundit procesi i decentralizimit i ka dhënë bashkive më shumë përgjegjësi në lidhje me sektorin e banesave; në veçanti ligji i fundit për Bashkëpronësinë, i cili i jep të drejtën dhe autoritetin bashkive për t'i kërkuar banorve të ndërtesave të banimit të formojnë asambletë e bashkëpronarve dhe të zgjedhin kryesinë e asamblesë, e cila do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e hapsirave kolektive. Në të njëjtën kohë ligji është një instrument i fuqishëm që bashkitë të mund të ndërhyjnë edhe në problemet e efiçiencës së energjisë në sektorin e banesave. Por ajo që duhet të kuptojmë është fakti që bashkitë nuk kanë akoma eksperiencë në zbatimin e ligjit të ri.
Në këtë kuadër projekti "Reduktimi i energjisë së përdorur dhe i emetimeve të CO_2 ndërmjet partneritetit të shoqërisë civile dhe pushtetit vendor për edukimin e popullsisë dhe rritjen e efiçiencës termike në ndërtesat e banimit" është iniciativa e fundit e ndërmarrë nga Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit, i cili do të tentojë të ndërtojë një partneritet midis shoqërisë civile dhe pushteti vendor (Bashkia Fier) për të rritur ndërgjegjësimin ndaj mundësive për kursimin e kostos duke rritur efiçiencën termike, duke përdorur fuqinë që Bashkisë i jep ligji i ri për Bashkëpronësinë.

TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

1 Të rrisë kapacitetet e pushtetit vendor në Bashkinë Fier lidhur me administrimin e efiçiencës së energjisë dhe Ligjin e ri të Bashkëpronësisë.

- Një veprimtari publike u organizuar në Bashkinë Fier, me pjesmarrjen e te gjitha paleve te perfshira ne projekt.
- Një Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua nga tri palët partnere, ku përkatësisht janë: Bashkia Fier, MPPTT dhe Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit
- Një grup punë në bashki u ngrit për zbatimin e projektit, dhe u organizua nje takim trajnues në lidhje me Ligjin e ri të Bashkëpronësisë

2 Vendosja e nje praktike pilot për efiçiencën e energjisë në ndërtesat ekzistuese të banimit në një zonë me të ardhura të ulta në qytetin e Fierit.

- 1 takim u organizua me grupin e punës për përzgjedhjen e zonës pilot si dhe të metodologjisë per tu perdorur
- Kryerja e nje1 pyetësori, 7 vizita në terren ne 4 ndërtesa banimi me 90 familjeve
- Lajmërime nga punonjësitë e bashkisë për të vënë në dijeni banorët e ndërtesës pilot që janë përzgjedhur për projektin duke u njoftuar për vendin dhe orën e takimit me grupin e punës
- 2 auditime energjitike në të gjitha apartamentet e ndërtesës pilot, para ndërhyrjeve në fasadën e jashtme dhe pas tyre

3 Rritja e ndërgjegjësimit, në qytetin e Fierit dhe më gjerë, mbi përfitimet e efiçiencës së energjisë në ndërtesat e banimit.

- Përgatitja dhe shpërndarja e 100 pamfletëve informuese në zonën pilot mbi përfitimet e efiçiencës së energjisë dhe Ligjin e ri të Bashkëpronësisë
- Hartimi dhe publikimi i një udhëzuesi praktik në lidhje me efiçiencën termike në ndërtesat e banimit dhe Ligjin e te ri të Bashkëpronësisë

BANESA PARAFABRIKATE
E PATERMOIZOLUAR



BANESA PARAFABRIKATE
E TERMOIZOLUAR 30% +
EFICENCE ENERGJIE



INSTRUMENTET FINANCIARE AFATMESME

Koha e Zbatimit: 2010 - 2012
Donatori: LGI & Instituti për Shoqërinë e Hapur (OSI) - Budapest
Fondi: $ 122, 710
Zbatohet në: Bashkitë Berat, Lezhë, Korçë, dhe Fier

Ky projekt vjen si një qasje e kërkesës drejtuar bashkive Berat, Lezhë, Korçë dhe Fierit në veçanti dhe gjithë qeverive vendore në Shqipëri, të cilat janë duke u përballur me sfidën për tu zhvendosur nga përgatitja tradicionale e buxhetit – bazuar ne shifra, në një dokument shumë-planësh, i cili artikulon politikat fiskale dhe programin e Politikave dhe ja komunikon këto Politika një publiku të ndryshëm. Co-PLAN, në rolin e organizatës kryesore të zbatimit, ka ndërtuar mbi eksperiencën dhe marrëdhëniet e ngushta të punës më njësitë qeverisëse vendore.
Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të konsolidojë kapacitetet bashkiake, për të përdorur Programinin për buxhetimin afatmesëm si një mjet për të artikuluar politika fiskale dhe politikën e programit, përmes një proçesi te gjerë pjesmarrjeje në mënyre që t'i komunikoje keto politika një publiku të ndryshëm.
Projekti adreson dy çështje kryesore: (i) mbështet qeverinë vendore në zhvillimin e programit të buxhetit afatmesëm. & praktikave të reja financiare për përfitime afat-gjata përmes një proçesi pjesëmarrjeje dhe (ii) harton direktiva për zbatimin e ligjit mbi programin e buxhetimit afatmesëm në nivel vendor në bashkepunim me Ministrinë e Financave, dhe shoqatat që përfaqesojnë qeveritë vendore.
Ky project synon ndërtimin e kapaciteteve vendore: për të përgatitur dhe për ta bëre të përdorshme MTBP; për të filluar politika për financime të reja në nivel vendor permes PPPs dhe instrumentave të tjerë të zhvillimit; dhe për të përmirësuar performancën e përgjithshme financiare përmes të ardhurave më të mira nga taksat veçanërisht taksën e pronës. Gjithashtu synon të përgatisë rekomandime për implementimin më të mirë të ligjit mbi sistemin e buxhetin për qeveritë vendore në bashkëpunim me Shoqatën e Bashkive te Shqipërise, MoF, LGs and OJQ. Së fundmi ka për qëllim të hartojë direktivave për implementimin e ligjit te MTBP nga perspektiva e qeverisë vendore dhe të shpërndajë eksperiencen e pilotuar ne 6 bashkite, në te gjtha njesite vendore përmes diskutimeve publike dhe takimeve.

TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

1 4 Bashkite do të udhëhiqen drejt rritjes se zhvillimi te tyre ekonomik MTBP.

- Programet për MTBP janë dizenjuar duke u bazuar në objektivat strategjike të parashikuara në LEDS nq bashkitë e Fierit, Beratit dhe Lezhës
- Dy dokumentat që lidhin MTBP ëith LEDS janë përgatitur nga bashkitë e Fierit dhe Beratit
- MTBP e pregatitura nga Bashkia e Beratit janë të miratuara nga Këshilli i qytetit

2 Qytetaret dhe shoqeria civile do të përfshihen në proçesin e përgatitjes së MTBP, për të garantuar transparencën dhe konstituencën e dokumentit

- Katër takime u organizuan në bashkitë e Fierit, Beratit ,Lezhës dhe Korçës me organizatat për shoqerinë civile dhe qytetarët për ti prezantuar programin dhe objektivat e MTBPs dhe buxhetin vjetor
- Rreth 120 pjesmarrës te cilët perfaqesonin organizatat e shoqerisë civile dhe qytetarë morën pjesë në keto takime.

3 Kuadri ligjor për sistemin buxhetor për qeverine vendore do të përmiresohet sipas nevojave të qeverisë vendore

- Një tryezë e rrumbullakët u organizua me perfaqesues të Ministrisë së Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore per te diskutuar mbi sfidat me të cilat po përballen njësite e qeverisjes vendore në përgatitjen e MTBP
- 50 pjesmarrës – zv. Ministri I Financave, drejtori për lidhjet ndërqeveritare në mInistrinë e fianancave, zyrtarë tëlartë nga njësitë e qeverisjes vendore , ADF, donatorë, etc. moren pjese ne kete tryeze te rrumbullaket
- Një dokument politik u përgatit në vijim të kësaj tryeze dhe ju dorëzua të gjitha pjesëmarrësve dhe palëve të interesuara



TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

4 Qeveritë vendore do të rishikojnë metodologjinë e mundesuar nga projekti në bashkitë e perzgjedhura dhe kjo do të lehtesoje proçesin e përgatitjes së MTBP

- Duke ndjekur qasjn e Co-PLAN në njësitë e qeverisjes vendore donatorë të tjerë kanë filluar të punojnë në të njëjtën fushë , duke përdorur metodologjinë e njëjtë.

5 Rritja e kapaciteteve vendore në menaxhimin e financave bashkiake dhe arkitekturës fiskale

- 8 trajnime u organizuan me stafin e bashkisë të përfshirëne këtë proçesin e përgatitjes se MTBP, në tre bashkite
- Rreth 30 persona staf I bashkisëmoren pjesë ne keto sesione
- Më shumëse 15 zyrtarë të qeverisë vendore janë ndihmuar dhe trajnuar përmes trajnimit në punë dhe asistencës.

LIGJI PËR PLANIFIKIMIN E TERRITORIT

Koha e Zbatimit: 2010
Donatori: USAID, ARD, Co-PLAN
Fondi: 9,806,000 LEKË
Zbatohet në: Tiranë

Në vitin 2009, Kuvendi Shqipëtar miratoi Ligjin e Planifikimit të Territorit. Duke marrë parasysh që Shqipëria është karakterizuar nga një manaxhim urban dhe planifikim i dobët i tokës në 20 vitet e fundit, rëndësia e një ligji të planifikimit të territorit nuk mund të nënvlerësohet.
Në rastin më të mirë, mund të shikohet si një nxitës në ndërmarrjen e iniciativave me synim përforcimin e praktikave të planifikimit dhe menaxhimit urban në plan kombëtar. Për tu siguruar për një zbatim sa më realist të mundshëm në kontekstin aktual shqipëtar dhe një përqasje me legjislacionin ekzistues, është thelbësore që:
1 - T'i kushtohet vëmendje e veçantë përgatitjes së akteve nënligjore, dhe
2 – Të hartohet në mënyrë të tillë që të lehtësojë menaxhimin e mirë urban të problematikës së trashëguar dhe zhvillim të qëndrueshëm.
Për këto arsye, Co-PLAN u angazhua në projektin e USAID për Programe të Qeverisë Vendore në Shqipëri (PQVSH), për të asistuar në hartimin e akteve nënligjore për implementimin e Ligjit të Planifikimit të Territorit.

Në funksion të hartimit, projekti fillimisht u përqëndrua në përftimin e një tabloje të qartë të problematikës në lidhje me çështjet e planifikimit të territorit, në nivel vendor e qëndror, për të parandaluar probleme gjatë fazës së zbatimit. Ky proçes në thelb pati dialogun dhe bashkëpunimin e të gjitha palëve të përfshira apo të interesuara, dhe u mundësua nga një grup pune.
Një document i përbërë nga tri rregullore, sikurse parashikohet me ligj, përkatësisht: Rregullorja e Unifikuar e Planifikimit, Rregullorja e Unifikuar e Kontrollit të Zhvillimit, dhe Rregullorja e Modelit të Planifikimit, iu dorëzua Qeverisë Shqipëtare në Nëntor 2010.
Zhvillime të mëtejshme priten në Shtator 2011, kohë kur qeveria Shqipëtare planifikon të shqyrtojë aktet nënligjore të ligjit të planifikimit të territorit.

TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

1 Mbështet njësitë vendore në zhvillimin e rekomandimeve për aktet nënligjore të Ligjit të Planifikimit të Territorit, dhe inkurajon bashkëpunimin e njësive vendore dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT).

- Një seri prej katëe tryezash u organizuan më njësitë vendore për informimin mbi Ligjin e Planifikimit të Territorit, dhe rëndësinë e tij.
- U intervistuan pesembëdhjetë përfaqsues të njësive vendore në pesëmbëdhjetë njësi të ndryshme, ku u hodh dritë mbi cështje me interes në lidhje legjislacionin e planifikimit të territorit.
- Gjatë takimeve të punës, u identifikuan një seri problematikash në nivel vendor, dhe në bazë prioriteti, u dokumentuan dhe raportuan me shkrim.
- Një dokument politik dhe plan pune u përgatitën për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm, për hartimiin e akteve nënligjore dhe zbatimin e ligjit, dhe ju dorëzua AKPT-së.

2 Të asistohet AKPT në hartimin e tre elementëve bazë të akteve nënligjore të domosdoshme, sikurse parashikohet në ligj, nëpërmjet pjesëmarrjes së të gjitha palëve të interesuara.

- U nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi mes AKPT dhe PQVSH në Maj 2010, me qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit të dy palëve.
- Ngritja e një grupi pune për aktet nënligjore, dhe prodhimi i një metodologjie, dhe një plani pun., Gjithashtu, u përcaktuan përgjegjësi e detyrat e anëtarëve të grupit të punës, bazuar në rezultatet e takimeve.
- Një vlerësim i shpejtë i katër zonave urban u ndërmorr nga AKPT, përkatësisht në qytetet e Vlorës, Durrësit, Shkodrës dhe Kamzës, për të përcaktuar metodologjinë dhe terminologjinë e përshtatshme për tu përdorur në aktet nënligjore.
- Juristët e AKPT hartuan një hartë të legjislacionit te domosdoshëm për tu shqyrtuar, gjatë proçesit të hartimit të akteve nënligjore.
- Tre strukturat bazë të rregulloreve, përkatesisht Rregullorja e Unifikuar e Planifikimit, Rregullorja e Unifikuar e Kontrollit të Zhvillimit, dhe Rregullorja e Modelit të Planifikimit, ju dorëzuan AKPT-se për shqyrtim.
- Në vijim të tri proçesesh hartimi, u dorëzuan për shqyrtim pranë AKPT-së, tre rregulloret ne formën draft me 30 Nëntor 2010.



TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

3 Mbështet AKPT-në në fillimin e një proçesi dialogu dhe pjesëmarrjeje intensive për zhvillimin e tri elementëve thelbësorë , përkatësisht: Rregullorja e Unifikuar e Planifikimit, Rregullorja e Unifikuar e Kontrollit të Zhvillimit, dhe Rregullorja e Modelit të Planifikimit.

- Grupi i punës organizoi katër tryeza kombëtare për të diskutuar përmbajtjen e tre rregulloreve me pjesëmarrje te 30-40 palë të interesuara nga Ministritë e linjës, agjencitë kombëtare dhe Bashkia e Tiranës, ne çdo tryezë. Takime kokë-më-kokë u organizuan me rreth 10 institucione, p.sh, Bashkinë e Tiranës, Ministrinë e Bujqësisë, Zyrën e Rregjistrimit të Pasurive të paluajtshme, Inspektoriatin Kombëtar të Ndërtimit etj.
- "Një kërkesë për bashkëpunim dhe informacion" nga AKPT, ju dërgua institucioneve publike palë në Qershor 2010, dhe komentet në formë të shkruar të materialit paraprak të rregulloreve ju dërguan AKPT-së nga të gjitha këto ministri e agjenci.
- U mbajtën tre raunde takimesh 2-ditore me pjesëmarrjen e rreth 200 përfaqsuesve nga njësite vendore ne Shqipëri, për diskutimin e materialit paraprak të rregulloreve dhe përmirësimin e mëtejshëm bazuar në komente.

TRANSFERTAT NDËRQEVERITARE

Koha e Zbatimit: Prill 2010 - Shkurt 2011
Donatori: LGI, Instituti për Shoqërinë e Hapur (OSI) - Budapest
Fondi: $ 40,853 bashkë-financuar, $ 30,670 LGI/OSI, $ 10,183 Co-PLAN
Zbatohet në: Shqipëri

Transfertat Ndërqeveritare në Shqipëri, me fokus të veçantë në marrëdhëniet e tyre me politikën qendrore, përbëjnë temën kërkimore për këtë projekt, i cili në vetvete është konsideruar si një studim shkencor.
Studim vjen si një vijimësi e punës së ndërmerrë nga Co-PLAN me tetë komunat duke ndihmuar ato për të përmirësuar zhvillimin ekonomik vendor dhe performancën financiare përmes hartimit të planeve të investimeve kapitale dhe mbledhjen e taksave.
Qëllimi i përgjithshëm i studimit hulumtim është të gjenerojë diskutime politike në lidhje me mënyrën si të ardhurat lokale rrjedhin nga burimet kombëtare, dhe cila mund të jetë alternativa politike për të drejtuar hartimin e transfertave ndërqeveritare dhe për të matur performancën e tyre.
Pyetje kryesore u përqëndruan në:
Si është hartuar sistemi i transfertave ndërqeveritare në Shqipëri?
Cilat janë detyrat e përcaktuara për transfertat brënda këtij sistemi?
Duke konsideruar sfondin historik të transfertave ndërqeveritare në Shqipëri, cila ka qënë marrëdhënia midis shpërndarjes së transferatave (veçanërisht granteve konkuruese)dhe sfondi politik në nivel qendror dhe vendore?
A është e domosdoshme të kodifikohen rregullat që rregullojnë alokimin e transfertave ndërqeveritare në një formë të përhershme të legjislacionit?
Cilat janë eksperiencat e vendeve të tjera të Evropës Lindore lidhur me rregullat për transfertat ndërqeveritare?
Përmes punës kërkimore, mbledhjes së të dhënave cilësore dhe sasiore studimi gjeneron në një informacion të përditësuar për transfertat ndërqeveritare me kriteret përkatëse, analizon tendencat dhe modelet, dhe mund dhe mundëson rekomandimet politike për të dyja, për qeverisjen vendore dhe locale dhe aktorëve të tjerë të interesuar.

TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

1 Diskutimi i përgjithshëm mbi kriterin preferencial politik për mundësimin e të ardhurave vendore nga të ardhurat kombëtare, do të kanalizohet në një diskutim politik në lidhje me rregullat/kriteret e transfertave ndërqeveritare.

- Metodologjia për analizimin e sistemit të transfertave ndërqeveritare në Shqipëri dhe të dhënat është përgatitur dhe vlerësuar me aktorët e interesuar.
- U plotësuan 74 pyetsorë nga njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri
- U përfshinë në projekt 3 shoqata që përfaqsonin njësitë e qeverisjes vendore në Shqipëri
- U ndërmorën 12 intervista të hapura me kryetarë, ekspertë, dhe vendimmarrës, të cilët ishin të përfshirë në skemën e granteve konkuruese.
- U përgatit një studim kërkimor mbi sistemin e transfertave ndërqeveritare në Shqipëri.
- U përgatit një dokument politikash duke ndjekur një studim kërkimor mbi sistemin e transfertave ndërqeveritare në Shqipëri.

2 Si qeveria qendrore dhe vendore duhet të bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e hartimit të rregullave të qarta transparente dhe të kodifikuara për shpërndarjen e transfertave

- U organizuan 5 takime me Ministrinë e Financave dhe organizata që përfaqësonin njësitë vendore lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e studimit kërkimor.
- Një tavolinë e rrumbullakët e organizuar për diskutimin e rekomandimeve politike lidhur me sistemin e transfertave ndërqeveritare në Shqipëri
- Një artikull u përgatit dhe u botua në revistat profesionale lidhur me gjetjet dhe rekomandimet mbi sistemin e transfertave ndërqeveritare në Shqipëri.

TAKSA E PASURISË - NJË INSTRUMENT PËR FINANCIME TË REJA NË NIVEL VENDOR

Koha e Zbatimit: Tetor 2009 - Shtator 2010
Donatori: USAID, Think Tank Fund/ Instituti për Shoqërinë e Hapur (OSI) - Budapest
Fondi: 1,920,350 LEKË
Zbatohet në: Shqipëri

Një nga burimet kryesore të të ardhurave për qeveritë vendore, është ajo e tatimit të pronës së patundshme (apo më saktësisht, tatimi mbi ndërtesat), i cili administrohet aktualisht nga qeveria vendore.. Kjo sjell një kontribut relativisht të vogël të të ardhurave vendore. Ndonëse Parlamenti rriti përqindjen e taksës së pasurisë së paluajtshme, kjo taksë është marrë nga qeverisja vendore 100%,në 2003, në vitin 2007 kjo taksë akoma kontriboi vetëm 5% në të ardhurat e qeverisjes vendore dhe ishte ekuivalente me 3 $ për person, ose me 0.1% e GDP. Pjesërisht, kjo derivon nga dobësia e theksuar e menaxhimit të kësaj takse, tipar i përbashkët për vendet në tranzicion ekonomik. Mbledhja e kësaj takse është në nivel të ulët- pronat janë rregjistruar ose deklaruar vetëm me dëshirën e pronarit ose si mundësi e fundit. Vlerat e taksës bazohen në karakteristikat e pronës të raportuar nga pronari/mbajtësit dhe në shumicën e rasteve ato janë të raportuara në nivele shumë të ulta. Eficienca në mbledhjen e taksës është e ulët. Kjo është e dukshme në shumën e mbledhur: jo më shumë se 50% e potencialit të pritur.
Për këto arsye, eksplorimi i taksës së pasurisë në të gjithë kompliksitetin, ishte një hap tjetër, i cili u ndërmorr nga Co-PLAN, në kuadër të projektit "Taksa e Pronës – një instrument për financimet e reja në nivel vendor në Shqipëri" i bashkëfinancuar nga LGPA (Programi për Qverisjen Vendore në Shqipëri) dhe "Institutit për Shoqërinë e Hapur" përmes projektit "Ndikimi në hartimin e politikave". Ky projekt erdhi në vijimësi të punës së kryer në shumë bashki për të ndihmuar në përmirësimin e performancës financiare dhe fiskale përmes përgatitjes së planeve vendore për financimet kapitale dhe mbledhjen më të mire të taksave.
Projekti filloi në Tetor 2009 dhe u përfundua zyrtarisht me një tryezë të rrumbullakët në Tetor 2010, ku gjetjet dhe rezultatet e këtij studimit, të ndërmarrë në kuadër të këtij projekti,u ndanë dhe u vlerësuan nga grupet e interesit pjesëmarrëse, ekspertë nga njësite e qeverisjes vendore, përfaqësues të ministrive dhe agjenci të tjera qeveritare.
Objektivat kryesore të projektit ishin: (i) të mbledhë informacionin cilësor dhe sasior mbi këtë temë; (ii) të analizojë informacionin dhe të dhënat e mbledhura; (iii) pregatisë raportin dhe document politikash; (iv) pregatisë planin veprues për qeverinë vendore.

TREGUESIT E ARRITJES & OBJEKTIVAT

1 Mbledhja e informacionit cilësor dhe sasior mbi këtë temë:

- Studimi metodologjik u hartua dhe u vlerësua
- Ndërmarrja e suksesshme e një anketë bazuar në informacionin e mbledhur nga hartat e përditësuara historike dhe ajrore për 10 qytete (Shkodër, Lezhë, Tiranë, Durrës, Elbasan, Fier, Lushnje, Vlorë, Korçë dhe Sarandë)
- U hartua dhe u përgatit një database në përputhje me informacionin e mbledhur nga anketa.
- 15 intervista dhe takime u organizuan me përfaqësues të lartë nga tetë bashki të ndryshme (Fier, Lezhë, Durrës, Shkodër, Korçë, Berat, Kukës, Fushë Krujë) në lidhje me taksën e pronës
- Një takim u organizua me përfaqësues të lartë të Ministrisë se Financave për temën kërkimore.

2 Të analizojë informacionin dhe të dhënat e mbledhura

- Një database u hartua dhe u përgatit në GIS për të analizuar të gjithë informacionin e mbledhur nga anketat
- Janë përgatitur më shumë se 60 harta tematike dhe synthesis /blueprints bazuar në analizën e informacionit
- Janë hartuar 5 dokumente në lidhje me situatën e administrimit të taksës së ndërtimit dhe menaxhimit në nivel vendor

3 Të përgatisë një raport kërkimor dhe një dokument politikash

- U përgatit një raport kërkimor për të diskutuar mbi mënyrat e reja të qeverisjes vendore, mënyra e miratimit të taksave që lidhen me strehimin për gjenerim më të lartë të të ardhura për investime kapitale
- U përgatit një dokument politikash me rekomandime për institucionet publike në nivel qendror dhe vendor mbi përdorimin e taksës së pronës si një instrument për të udhëhequr përdorimin e tokës dhe administrimit në Shqipëri




TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

4 Të përgatisë planin e veprimit për qeveritë vendore

- Treguesit e ArritjesNjë plan veprimi afatshkurtër u përgatit dhe u dorëzua në 10 njesi te qeverisjes vendore lidhur me një administrimin më të mire dhe menaxhim të taksës së Pronës
- Një plan veprimi afatmesëm u përgatit per te dy institucionet e qeverisjes vendore mbi mënyrën e përdorimit më mirë të potencialit të taksës mbi pronën


DURRËSI



STUDIM FIZIBILITETI PËR KRIJIMIN E NJË ZONE INDUSTRIALE NË LEZHË

Koha e Zbatimit: Shtator 2009 - Prill 2010
Donatori: USAID
Fondi: 1,958,000 LEKË
Zbatohet në: Bashkia Lezhë

Projekti “Studim fizibiliteti për krijimin e një zone industriale në Lezhe ” ka filluar të zbatohet pas marrëveshjes së nënshkruar me Bashkinë e Lezhës dhe Programin LGPA, në fund të tetorit 2009. Projekti do të shërbejë si një instrument për të drejtuar investimet private vendim-marrjen brenda komunës dhe të lidhë këto investime me projektet e investimeve në sektorin publik. Studimi i fizibilitetit do të ofrojë një bazë për zhvillimin e (nga të tjerët) një studim të detajuar urbanistik të zonës industriale dhe një dokument formal te Vleresimit të Ndikimit në Mjedis.
Studimi i fizibilitetit ka për qëllim të udhëheqë zhvillimin e qëndrueshëm fizike dhe ekonomike të qytetit të Lezhës, në përputhje me sfidat e zhvillimit aktual, kërkesat ekonomike për hapësirë industriale, dhe iniciativacën për projektet lokale dhe rajonale të zhvillimit të infrastrukturës



TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

1 Për të mbledhur të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me zonën industriale

- 6 takime organizuar perms grupit të punës me METE, ALBINVEST, ANTRACO, GRD/MPWTT, Qarku i Lezhës
- Harta e Pronës dhe Informacioni përaktës, përditësimi I sitit perms grupit të punës
- Dy takime koordinuese dhe organizimin e takime të tjera me përfaqsuesit local të Water Supply Enterprise, KESH, AlbTelecom, etc.

2 Për të përgatitur analiza fizike dhe hapësinore për zonen e propozuar industriale

- Dy takime të organizuara me grupin e punës për të diskutuar për analizën fizike dhe hapësinore.
- Tetë harta tematike për të paraqitur këtu analizën fizike dhe hapësinore janë theksuar avantazhet dhe disavanazhet e lokacionit dhe faktorë te tjerë
- Dhjetë stafe locale u asistuan direct përmes trajnimi në punë duke lidhur dokumentat strategjik me instrumentat financiar(buxhete vjetore, buxhetet afatmesëm, etj)
- Një workshop u organizua me target qeverisja vendore në pregatitjen e programit për buxhetimin aftamesëm dhe dokumenta alternative and alternative strategic financial documents
- Një workshop u organizua me targeted LGs to share, diskutime, dhe përgatitja e rekomandimeve për përgatitjen e programit të buxhetit afatmesëm në njësitë e vogla vendore.

RRJETI I INFORMACIONIT MBI QEVERISJEN VENDORE - LOGIN

Koha e Zbatimit: 2009 - 2010
Donatori: LGI & Instituti për Shoqërinë e Hapur (OSI) - Budapest
Fondi: $ 29,630
Zbatohet në: Shqipëri

Viti 2010 shënoi dhe një tjetër vit të suksesshëm në promovimin dhe rritjen e mëtejshme të LOGIN - Rrjeti i informacionit mbi qeverisjen vendore në Shqipëri. Një shumë prej 515 dokumentash, në gjuhën Shqipe dhe Angleze, ju shtuan platformës online të LOGIN, duke nxitur dhe më tej zhvillimin profesional të burimeve njërëzore të njësive të qeverisjes vendore, dhe forcimin e kapaciteteve të organizatave që mbështesin reformën e administratës publike në nivel vendor.
Ky projekt është në proçes implementimi dhe në pesëmbëdhjetë vende ish-komuniste të Evropës Qëndrore dhe Lindore, të cilat u janë përkushtuar nxitjes dhe zhvillimit të kapacitetit dhe reformave të decentralizimit. LOGIN ofron informacion mbi çështje të qeverisjes vendore, si per shembull legjislacioni i ri, proçedura të reja, financime, dhe mundësi trainimi. Përpos qëllimeve të tjera, platform do të ofrojë në rregullisht lajme të lidhura me proçesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke u përqëndruar në nevojat dhe mundësite.

Ky vit (2010) shënoi një numër përdoruesish në rritje, me 23627 shkarkime informacioni deri në fund të muajit Nëntor 2010. Krahas komenteve të dhëna gjatë konferencave kombëtare, apo tryëzave dhe takimeve të organizuara nga Co-PLAN dhe partnerët e tij, u organizua një pyetësor në 397 njësitë e qeverisjes vendore. Pyetësori preku tema të lidhura me informacionin mbi LOGIN dhe mundësinë për ta përdorur atë; ndërsa të gjitha njësitë ishin të mirë informuar mbi LOGIN, infrastruktura e dobët teknologjike, përbënte problem për disa prej njësive – kryesisht zonat e largëta të Shqipërisë. Ky problem u zgjidh përmes ofrimit të të gjithë informacionit të hedhur në LOGIN gjatë vitit, nëpërmjet DVD-ve.

THE LOCAL GOVERMENT INFORMATION NETWORK

TREGUESIT E ARRITJES & OBJEKTIVAT

1 Pasurimi i platformës LOGIN në tetë modulet e saj.

- Platforma LOGIN është operative në tetë module dhe është e arritshme nga faqet e internetit të Co-PLAN (HYPERLINK "http://www.co-plan.org" www.co-plan.org), SHBSH (www.aam-al.com), U_POLIS (www.universitetipolis.edu.al), dhe SHKSH (www.aac@abcom.al).
- 515 dokumente, raporte, dhe informacione te hedhura dhe një shumë prej 23627 shkarkimesh të shënuara.

2 Zgjerimi i rrjetit të partnerëve për ndarjen e informacionit dhe eksperiencave.

- Marrëveshje bashkëpunimi në proçes për pasurimin e platformës me material dhe përgatitjen e aktiviteteve të përbashkëta.

3 Promovimi i LOGIN si një platformë njohurish mbi çështje të pushtetit vendor dhe mbi reformën në administratën publike

- Artikuj mbi LOGIN u publikuan (4), në gazetat e SHBSH dhe SHKSH ;
- U shpërndanë broshura dhe material elektronike me informacionet e hedhura deri tani në platformë në 385 njësi të qeverisjes vendore;
- Bashkëpunimi më organizimin e aktiviteteve të ndryshme të të gjithë partnerëve të kësaj platform me focus në çështjet e pushtetit vendor dhe reformën në administratën publike.


4 Pasqyrimi i informacionit mbi mudësi trainimi, financimi e mbështetjeje teknike për aspekte të ndryshme të qeverisjes vendore

- Integrimi në LOGIN i një moduli për 'trainime të planifikuara' të organizuara nga të gjithë anëtarët e rrjetit;
- Postimi në platform i një liste sitesh dhe institucionesh e organizatash që ofrojnë mundësi trainimi;
- Integrimi në platform i një kalendari aktivitetesh të planifikuara të njësive vendore në nivel kombëtar.

HARTIMI I PLANIT TË PËRGJITHSHËM RREGULLUES TË KUKËS / FUSHE - KRUJË

Koha e Zbatimit: Tetor 2008 - Prill 2010
Donatori: USAID, Bashkia Fushë - Krujë, Bashkia Kukës
Fondi: 21,680,955 LEKË
Zbatohet ne: Bashkia Fushë - Krujë, Bashkia Kukës

Projektet e Planeve të Përgjithshme Rregulluese të qyteteve të Fushë Krujës dhe Kukësit janë pjesë e Programit LGPA të financuar nga USAID dhe të zbatuar nga ARD. Co-PLAN, si partneri lokal i LGPA-së, ka punuar ngushtësisht me Bashkitë per t'ju siguruar atyre asistencën e nevojshme teknike në proçesin e përgatitjes së Planeve të Përgjithshme Rregulluese të bashkive.
Këto plane rregulluese do te jenë instrumente të fuqishme që do të udhëheqin investimet private në bashki dhe do të sjellin në një linjë këto zhvillime me projektet për investime të sektorit publik. Planet synojnë të orientojë një zhvillim fizik dhe ekonomik të qëndrueshëm në përputhje me sfidat aktuale të zhvillimit si dhe gjithashtu projektet dhe iniciativat e tjera rajonale. Gjithashtu, këto Plane do të udhëheqin zhvillimet ekonomike dhe do ti pozicionojë bashkitë si qendra të rëndësishme urbane në rajon. Proçesi i punës u krye në bashkepunim të ngushtë e të vazhdueshëm me njësitë vendore dhe grupet e punës të ngritura pranë tyre.



TREGUESIT E ARRITJES

& OBJEKTIVAT

1 Hartimi Planit të Përgjithshem Rregullues te Bashkise Fushë Krujë dhe Kukës

- Konsolidimi i draft skemave për Planin e Përgjithshëm Rregullues
- Konsultimi i draft skemave brenda grupit të punës
- Konsultimi i draft skemave me aktorët e tjerë të perfshirë në proçes
- Rakordimi me planet e vetë bashkisë në kuadër të investimeve kapitale
- Prezantimi për publikun e gjerë me pjesëmarrjen e gjithë të interesuarve
- Reflektimi i sygjerimeve të publikut
- Ideimi dhe hartimi i relacionit te Planit të Përgjithshëm Rregullues
- Ideimi i hartave tematike të Planit të Përgjithshëm Rregullues
- Ideimi i projekt ideve te infrastrukturave inxhinjerike
- Mbi 10 takime janë organizuar me grupin e punës ne bashki me qëllim diskutimin e elementeve të propozimeve territoriale të planit
- 1 seminar u zhvilluan ne kete faze te projektit ku u diskutua mbi format dhe drejtimet e transformimit të territorit urban dhe zonës përreth
- Nje databazë GIS-i u dizenjua dhe u përgatit për Termat e Referencës dhe për Planin e Përgjithshëm Rregullues

2 Hartimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor

- Analizë e problematikes mjedisore në bashki për tokën, ajrin, ujin, biodiversitetin, mbeturinat etj.
- Përcaktim i vlerësimit mjedisor për propozimet e planit
- Përcaktim i fazave të monitorimit dhe indikatorëve
- Parashikimi i masave zbutëse dhe rekomandimeve
- Ideimi i 2 hartave tematike për problematikën mjedisore

RAPORTI FINANCIAR



- RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR
- POZICIONI FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2010

FINANCAT DHE TRANSPARENCA NË Co - PLAN

Raport i auditorëve të pavarur
Për Drejtorin Ekzekutiv të Co-PLAN,
Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Ne kemi audituar bilancin kontabël të Co-PLAN, Instituti per Zhvillimin e Habitatit (e quajtur këtej e tutje si “Organizata” ose “Co-PLAN”) për periudhën deri më 31 Dhjetor 2010. Strukturat menaxhuese të Co-Plan janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare. Përgjegjësia jonë është të japim mendim mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë.
Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Sipas këtyre standarteve ne jemi të detyruar të planifikojmë dhe ushtrojmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme mbi faktin nëse këto pasqyra financiare nuk përmbajnë gabime ose shmangie materiale. Një auditim përfshin zbatimin e disa proçedurave me qëllim marrjen e evidencës mbi shumat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare.. Një auditim përfshin gjithashtu edhe vlerësimin e parimeve kontabël të përdorura dhe gjykimeve të rëndësishme të bëra nga strukturat menaxhuese, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare. Ne besojmë që evidenca e auditimit e siguruar
prej nesh siguron një bazë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë gjykimin tonë.
Këto pasqyra financiare janë përgatitur bazuar në një kosto historike, sipas parimit të regjistrimit të dyfishtë, në përputhje me metodën “kontabilizim fondesh”, e cila ndryshon nga Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar dhe Legjislacioni Shqiptar për Kontabilitetin.
Sipas vlerësimit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të saktë të gjendjes financiare të Organizatës deri më 31 Dhjetor 2010, si dhe të performancës së vet financiare dhe të fluksit të parave për vitin që mbyllet, në përputhje me metodën “kontabilizim fondesh”.
Ky raport lëshohet për informacion dhe përdorim vetëm të strukturave menaxhuese të Organizatës dhe për donatorët e saj. Rrjedhimisht, materiali nuk duhet përdorur për qëllime të tjera dhe për këtë arsye nuk duhet shpërndarë pa marrë më parë pëlqimin tonë me shkrim.

KPMG Albania sh.p.k
Rr. Dëshmorët e 4 Shkurtit, Kullat Binjake, Ndërtesa 1,
Kati 13
Tiranë, Shqipëri

KPMG Albania Sh.p.k
"Deshmorët e Kombit" Blvd
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania
NIPT J91619001D

Telephone +355 (4) 2274 524
+355 (4) 2274 534
Telefax +355 (4) 2235 534
E-mail al-office@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Independent Auditors' Report

To the Executive Director of
Co - PLAN Institute for Habitat Development

Tirana, 16 May 2011

Independent Auditor's Report

We have audited the accompanying financial statements of Co-PLAN Institute for Habitat Development (hereafter "the Organisation" or "Co-PLAN"), which comprise the balance sheet as at 31 December 2010, and the income statement and statement of cash flows for the year then ended, and a summary of significant accounting policies and other explanatory information. The financial statements have been prepared by management of Co-PLAN on the historical cost basis, following the accrual concept in accordance with the fund-accounting method. Our responsibility is to express an opinion on the financial statements based on our audit.

Management's Responsibility for the Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with the fund-accounting method as described in Note 2 of the financial statements and for such internal control as management determines is necessary to enable the preparation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error.

Auditors' Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance about whether the financial statements are free from material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. The procedures selected depend on our judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, we consider internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.

KPMG Albania, an Albanian limited liability company and a member firm of the KPMG network of independent member firms affiliated with KPMG International Cooperative ("KPMG International"), a Swiss entity.

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Opinion

In our opinion, the financial statements present fairly, in all material respects, the financial position of the Organisation as at 31 December 2010, and its financial performance and cash flows for the year then ended in accordance with the fund-accounting method as described in Note 2 of the financial statements.

Restriction on Distribution and Use

Our report is intended solely for the information and use of the management of the Organisation and its donors, and should not be further distributed to other parties or used for any other purposes without our prior written consent.

KPMG Albania Sh.p.k.

KPMG Albania Sh.p.k.
"Deshmorët e Kombit" Blvd.
Twin Towers Buildings
Building 1, 13th floor
Tirana, Albania

POZICIONI FINANCIAR 31.12.2010

Co-PLAN Institute for Habitat Development

Balance Sheet as at 31 December 2010

(in EUR)

	Note	31 December 2010	31 December 2009
Assets			
Cash and cash equivalents	4	802,412	753,160
Guarantee account	5	4,122	3,820
Project debtors	6	715,047	891,098
Other debtors	7	1,648	2,663
Fixed assets, net	8	164,364	125,294
Total assets		**1,687,593**	**1,776,035**
Liabilities, Project funding and other funds			
Liabilities	9	37,098	42,510
Project funding	10	712,561	945,410
Other funds	11	937,934	788,115
Total liabilities, Project funding and other funds		**1,687,593**	**1,776,035**


The Balance Sheet is to be read in conjunction with the notes set out on pages 4 to 26 and forming part of the financial statements.

The financial statements were authorised for issue by the Executive Director of Co-PLAN Institute for Habitat Development on 16 May 2011.

Dritan Shutina
Executive Director

Ogerta Gjiknuri
Finance Manager

Rrugëtimi 15 vjeçar i Co-PLAN



Co-PLAN's 15 year journey